



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i integruar i studimeve të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Drejtësi”

ofruar nga

Universiteti Privat "Albanian University"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Blerina Masha

Dr. Dorina Gjipali

Nëntor / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË: "DREJTËSI"

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko - Administrative
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program i Integruar i Studimeve të Ciklit të dytë Master i Shkencave në: "Drejtësi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 188, datë 03.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	300 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti 2020-2021 5 PAE / 4 PAK; Viti 2021-2022 11 PAE / 9 PAK; Viti 2022-2023 14 PAE / 9 PAK; Viti 2023-2024 15 PAE / 13 PAK; Viti 2024-2025 17 PAE / 4 PAK;
18	Numri i studentëve:	Viti 2020-2021 17 studentë Viti 2021-2022 14 studentë Viti 2022-2023 18 studentë Viti 2023-2024 14 studentë Viti 2024-2025 25 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Integruar i Studimeve të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave në Drejtësi” në Universitetin Privat “Albanian University” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, të Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Programi ka filluar në vitin akademik 2020–2021, në përputhje me ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për riorganizimin e programeve të integruara të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e drejtësisë.

Programi i studimit synon përgatitjen e specialistëve me formim të thelluar teorik, metodologjik dhe praktik në fushën e drejtësisë, në përputhje me misionin institucional të Albanian University për të ofruar arsim cilësor dhe bashkëkohor, të krahasueshëm me standardet evropiane të arsimit të lartë. Ky program është i licencuar me Urdhër MASR Nr. 188, datë 03.07.2020. Programi ofrohet me kohë të plotë dhe ka një kohëzgjatje prej pesë viteve akademike, duke qenë i ndërtuar mbi bazën e Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS) me një total prej 300 kreditesh. Në përfundim të studimeve, studentët përfitojnë diplomën “Master i Shkencave” në “Drejtësi”.

Procesi mësimor bazohet në integrimin e komponentëve teorikë me ato praktikë, përmes përfshirjes së studentëve në leksione, seminare, kërkime, projekte praktike dhe bashkëpunime me institucione të drejtësisë dhe organizata të tjera partnere. Programi mbështetet nga një staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe praktikë profesionale në fusha të ndryshme të së drejtës.

Objektivat kryesore të programit lidhen me zhvillimin e aftësive për analizë kritike të problematikave juridike, zbatimin e drejtë të ligjit, aftësinë interpretuese dhe ndërtimin e integritetit profesional e etik të juristëve të rinj.

Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën “Master i Shkencave” në “Drejtësi”, që u mundëson të ushtrojnë profesionet përkatëse në administratën publike, sistemin gjyqësor, avokati, noteri, ose në sektorin privat, si dhe të ndjekin studimet pasuniversitare në Shkollën e Magjistraturës apo të vijojnë studimet doktorale.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e Programit të Integruar të Studimeve të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave në Drejtësi", i ofruar nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Universitetin Privat "Albanian University", është zhvilluar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit". Procesi nisi me shqyrtimin e Raportit të Vetëvlerësimit të përgatitur nga institucioni dhe dokumentet mbështetëse të tij dërguar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Bazuar në këtë dokumentacion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) analizoi përmbushjen e standardeve dhe kriterëve dhe përgatiti një listë pyetjesh që kërkonin sqarim gjatë vizitës në institucion. Për këtë proces, ASCAL përzgjedhi dy eksperte të jashtëm **Dr. Blerina Masha (Shkurti)**, dhe **Dr. Dorina Gjipali**, të cilat, të mbështetura teknikisht nga Znj. Majlinda Demirneli, realizuan vizitën institucionale në Universitetin Privat "Albanian University". Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi takime me Dekanen e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Përgjegjësen e Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, si dhe me stafin akademik, studentët, dhe përfaqësues të strukturave mbështetëse.

Gjatë vizitës u vëzhguan ambientet mësimore dhe biblioteka e universitetit, për të vlerësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë infrastrukturën dhe mjetet didaktike që mbështesin zhvillimin e programit të studimit. Ekspertët realizuan intervista të detajuara me pedagogët e programit, duke analizuar përputhjen e kurrikulës me objektivat e mësimdhënies dhe kompetencat që synohen të zhvillohen tek studentët. Po ashtu, u trajtuan çështje që lidhen me sigurimin e cilësisë, metodologjitë e mësimdhënies, vlerësimit të studentëve, mbështetjen akademike të stafit akademik dhe studentëve dhe praktikat profesionale. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit, u evidentua bashkëpunim i plotë nga ana e drejtuesve të institucionit dhe stafit akademik. Dokumentacioni i kërkuar nga grupi i ekspertëve u vu në dispozicion në kohë. Në përfundim, bazuar në analizën e dokumentacionit dhe rezultatet e vizitës në institucion, grupi përgatiti Raportin Final të Vlerësimit të Jashtëm, i cili paraqet gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me cilësinë dhe zhvillimin e programit.

Universiteti Privat "Albanian University", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.11.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 173/29 Prot, datë 03.11.2025. Universiteti Privat "Albanian University", njofton më datë 11.11.2025, nëpërmjet sistemit me anë të shkresës me nr. 392/1, prot, datë 11.11.2025, "Kthim përgjigje shkresës me nr 173/29 Prot, datë 03.11.2025", komentet mbi draft raportin.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. **Lidhur me komentin mbi Standardin II.3, Kriteri 4**, GVJ vlerëson eksperiencën praktike që stafi akademik me përvojë sjell në auditor dhe e konsideron atë vlerë të shtuar në procesin mësimor. Megjithatë duke qenë se mësimdhënia universitare kërkon baza të forta teorike dhe shkencore, në përputhje të drejtpërdrejtë me fushën e studimit si dhe kualifikimin e stafit

akademik, profili akademik e shkencor merr rëndësi në raport me lëndët në të cilat angazhohen. **Rekomandimi qëndron dhe raporti nuk ndryshohet.**

2. **Lidhur me komentin mbi Standardin IV.1, Kriteri 2,** GVJ vlerëson angazhimin e DSHPJA dhe përpjekjet e tij që të qëndrojnë konform udhëzimeve që rregullojnë ngarkesën mësimore të stafit akademik dhe përkatësisht Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 *“Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.”* Ky udhëzim parashikon mundësinë e zhvillimit të orëve suplementare të paguara përtej normës mësimore të përcaktuar, vetëm me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe me miratimin e drejtuesit të njësisë kryesore. Megjithatë, gjatë procesit të vlerësimit, GVJ nuk ka gjetur evidenca që vërtetojnë zbatimin e kësaj procedure, as në dokumentacionin e paraqitur nga GVB dhe as gjatë takimeve të zhvilluara, pavarësisht se kjo çështje është trajtuar edhe gjatë diskutimeve me përfaqësuesit e njësisë. Për më tepër, pika 6 e Kreut II të sipërcituar përcakton se *“Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbajë në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë në dy semestre, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore”*. Nga të dhënat e analizuar në raportin e GVB, rezulton se në disa raste ngarkesa mësimore e pedagogëve nuk është në përputhje me këtë dispozitë, pasi, për shkak të numrit të ulët të studentëve, ajo është shpërndarë në një numër më të madh lëndësh/modulësh mësimorë sesa parashikohet. Në këtë kuadër, GVJ sugjeron që të bëhet rishikimi i ngarkesës mësimore të stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi, në mënyrë që ajo të jetë plotësisht në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. **Rekomandimi mbetet në fuqi dhe raporti nuk ndryshon.**

3. **Lidhur me komentin mbi Standardin IV, Kriteri 1,** GVJ vlerëson sqarimin dhe evidencën e paraqitur nga institucioni lidhur me interpretimin e dispozitave ligjore mbi përbërjen dhe kualifikimet e personelit akademik të angazhuar në programe të integruara të ciklit të dytë. Megjithatë, theksohet se shkresa e MAS, me nr. 4719/13, datë 10.10.2023, përbën një akt administrativ, i cili nuk mund të prevalojë ndaj parashikimeve ligjore. Në këtë drejtim, mbetet përcaktuese dispozita e pikës 6 të nenit 59 të ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, sipas së cilës: *“Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.”* Duke qenë se programi i integruar i ciklit të dytë klasifikohet në mënyrë të qartë si program i ciklit të dytë të studimeve, kërkesa ligjore interpretohet në mënyrë të tillë që personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këto programe duhet të zotërojë së paku gradën shkencore “Doktor”. Për pasojë, edhe pse shkresa e MAS synon të ofrojë një interpretim të zbatueshëm në praktikë, ajo nuk mund të modifikojë apo të zbusë kërkesën detyruese të ligjit, i cili ka fuqi më të lartë juridike. Në këtë kuadër, GVJ mban qëndrimin se parashikimi ligjor ka epërsi ndaj çdo akti administrativ dhe se respektimi i hierarkisë së burimeve të së drejtës është thelbësor për garantimin e ligjshmërisë në veprimtarinë akademike. **Rekomandimi mbetet në fuqi dhe raporti nuk ndryshon.**



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencave në "Drejtësi"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni i arsimit të lartë, Universiteti Privat "Albanian University", ofron programe studimi që janë në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe janë të orientuara drejt nevojave të zhvillimit të shoqërisë dhe ekonomisë së vendit. Programi synon të pajisë studentët me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të përballuar sfidat aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë. Programi i studimit është bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe në aktet bazë të brendshme të institucionit të cilat synojnë të promovojnë dhe të nxisin studentët drejt përfuturit dhe aplikimit në praktikë të vlerave akademike dhe demokratike në shoqërinë shqiptare. <i>Evidenca 1.01 Statuti i AU</i> <i>Evidenca 1.02 Rregullore e përgjithshme e AU</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Integruar i Ciklit të Dytë në "Drejtësi" është zhvilluar në përputhje të plotë me qëllimet dhe parimet themelore të institucionit, të përcaktuara në statutin, rregulloren e përgjithshme dhe strategjinë institucionale. Duke respektuar këto akte themelore, ky program siguron përputhshmërinë me misionin e institucionit dhe me fushën e tij të veprimtarisë, duke u ofruar studentëve një kurrikulë të plotë dhe të harmonizuar me qëllimin dhe misionin e institucionit. <i>Evidenca 1.01 Statuti i AU</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në	Programi i Integruar i Ciklit të Dytë në Master i Shkencave në "Drejtësi" është zhvilluar duke respektuar strategjinë bazë të institucionit, e cila përcakton prioritetet për zhvillimin



zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	institucional dhe të programeve të studimit. Strategjia synon të formojë të diplomuar të aftë për tregun e punës, të cilët ndjekin standarde të larta etike dhe profesionale. Ky program kontribuon në realizimin e interesit kombëtar në fushën e arsimit dhe shkencës, duke siguruar që kurrikula dhe përmbajtja e lëndëve të jenë në përputhje me Statutin, Rregulloren dhe fushat akademike të institucionit. <i>Evidenca 1.01 Statuti AU</i> <i>Evidenca 1.02 Rregullore e AU</i> <i>Evidenca. 1.03 Strategjia per zhvillimin Institucional AU</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	GVJ vlerëson se programi i studimit “Master i Shkencave në Drejtësi” është hartuar dhe zhvillohet në përputhje të plotë me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe me interesin kombëtar. Programi implementohet mbi bazën e akteve të hartuara sipas këtyre strategjive, duke integruar gjithashtu prirjet dhe standardet globale të zhvillimit, dhe mbështetet në dokumentacionin përkatës vendor dhe ndërkombëtar. Kjo qasje siguron që programi të ofrojë një përgatitje të harmonizuar dhe cilësore për studentët, në përputhje me kërkesat akademike, profesionale dhe shoqërore.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i Integruar i Ciklit të Dytë në “Drejtësi” është hartuar dhe zhvillohet në përputhje të plotë me standardet kombëtare dhe strategjitë institucionale. Programi respekton interesin kombëtar dhe kontribuon në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore. Ai reflekton qëllimet dhe misionin e institucionit, duke u përshtatur me fushën e veprimtarisë dhe duke integruar prioritetet e zhvillimit institucional, Statutin dhe Rregulloren përkatëse.</i> <i>Programi gjithashtu merr parasysh strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe prirjet globale, duke u mbështetur në dokumentacionin vendor dhe ndërkombëtar, për të siguruar përgatitje cilësore akademike, profesionale dhe etike për studentët, në përputhje me nevojat e shoqërisë dhe të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



				X
--	--	--	--	---

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i Integruar i Ciklit të Dytë në “Drejtësi” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko Administrative në Fakultetin e Shkencave Shoqërore duke u mbështetur në një staf akademik të kualifikuar dhe me përvojë në fushën e drejtësisë. Anëtarët e stafit zotërojnë ekspertizë të provuar në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe praktikë profesionale, siç dokumentohet në CV-të e stafit akademik (<i>Evidenca 2.43</i>) Për vitin 2024-2025, Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko Administrative ka gjithsej 33 pedagogë, nga të cilët 14 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: - 1 ka titullin Prof. Dr.; - 1 ka titullin Prof. As; - 10 kanë gradën Dr.; - 2 janë Doktorantë. dhe 19 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku: - 1 ka titullin Prof. Dr.; - 3 kanë titullin Prof. As; - 8 kanë gradën Dr.; - 1 është Doktorantë. - 6 janë me Msc. <i>Evidenca 2.53 Tabela 1.5</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit	Programi i Integruar i Ciklit të Dytë të studimeve në “Drejtësi” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike e Politiko-Administrative, një nga tre njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Sociale. Fakulteti përbëhet gjithashtu nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. Në kuadër të zbatimit të VKM nr. 310, datë 11.05.2022, “Për specifikimet dhe përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të ofruara nga IAL në Republikën e



sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Shqipërisë”, programi i Integruar i Studimeve në Drejtësi është klasifikuar me kodin 75M10421S . <i>Evidenca 2.53 Tabela 1.5</i> <i>Evidenca 2.14 Shkresat per kodifikimin e programit</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i Integruar i Ciklit të Dytë në “Drejtësi” zhvillohet në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit të Shkencave Juridike e Politiko-Administrative, njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi. Kjo siguron përputhshmëri midis përmbajtjes akademike të programit dhe fushës së ekspertizës së njësisë, si dhe garanton që programi përmbush standardet e kërkuara për mësimdhënie dhe kërkim shkencor në nivel kombëtar dhe europian. <i>Evidenca 2.08 Rregullore e DSHJPA</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga takimet e GVJ me përfaqësues të Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumni, u konstatua se Dega për Këshillimin e Karrierës dhe Marrëdhënien me Alumni luan një rol thelbësor në përgatitjen profesionale të studentëve dhe të diplomuarve për integrimin në tregun e punës. Këto njësi funksionojnë si një urë lidhëse mes formimit akademik dhe kërkesave të tregut, duke ofruar mbështetje individuale dhe kolektive për studentët në orientimin e karrierës. Përmes bashkëpunimit me punëdhënësit dhe programeve të trajnimit të mëtijshëm, studentët dhe të diplomuarit përgatiten për sfidat profesionale dhe mund të përmbushin standardet e kërkuara nga tregu i punës. <i>Evidenca 2.20 Raport mbi marreveshjet</i>

Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Programi i Integruar i Ciklit të Dytë në "Drejtësi" është hartuar dhe zhvillohet në përputhje të plotë me strategjitë institucionale dhe kombëtare, misionin dhe objektivat e institucionit, si dhe me prirjet globale të zhvillimit akademik. Programi ofrohet nga një staf akademik me përvojë dhe mbështetet nga infrastruktura e duhur, duke siguruar një kurrikulë të harmonizuar me nevojat e tregut të punës dhe interesin kombëtar.</i> <i>Njësitë mbështetëse, si Dega për Këshillimin e Karrierës dhe Alumni, ofrojnë mbështetje profesionale dhe orientim për studentët dhe të diplomuarit, duke lidhur formimin akademik me kërkesat reale të profesionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni garanton një menaxhim efikas të programit të studimit duke promovuar bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet njësive dhe stafit akademik. Përgjegjësitë dhe detyrat janë të qarta dhe të ndara në mënyrë të qëndrueshme, duke siguruar koordinim të mirë mes strukturave administrative dhe akademike. Ky organizim mundëson monitorim të vazhdueshëm, vlerësim të performancës dhe përmirësim të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore, duke përfshirë edhe zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurikulare. Njësia bazë përgjegjëse për programin luan një rol kyç në mbikëqyrjen e realizimit të tij dhe garanton që puna të kryhet në përputhje me standardet institucionale dhe ligjore. <i>Evidenca 2.08 Rregullore e Departamentit,</i>

	<i>Evidenca 2.09 Raport vjetor i DSHJPA 23-24</i> <i>Evidenca 2.27 Raport i vleresimit te Departamentit per stafin akademik</i> <i>Evidenca 2.15.1 Vendime te Mbledhjes se Asamblese se personelit akademik</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Në përmbushje të objektivave të procesit mësimor dhe formimit profesional të studentëve, universiteti ka ndërtuar një rrjet bashkëpunimesh institucionale afatgjata, të cilat mbështeten në një strategji të qartë ndërkombëtarizimi dhe lidhjeje me tregun e punës. Zyra e Marrëdhënies me Jashtë, në bashkëpunim me departamentet, ushtron një monitorim të vazhdueshëm të mundësive për zgjerimin e partneriteteve ndërkombëtare dhe lokale, duke synuar rritjen e cilësisë së programeve dhe përmirësimin e kompetencave praktike të studentëve. Nga evidencat mbështetëse rezulton se universiteti është pjesë e rrjeteve si Mediterranean Middle East University Netëork, ETEN – European Teacher Education Network, si dhe bashkëpunon me universitete prestigjioze si Sapienza Università di Roma, Università degli Studi di Salerno, National University of Political Studies and Public Administration (Rumani) etj. Këto marrëveshje janë reflektuar konkretisht në aktivitete akademike dhe mobilitete studentore, çka tregon se bashkëpunimet zbatohen në praktikë. <i>Evidenca 1.03 Strategjia për Zhvillimin Institucional 2023–2028</i> <i>Evidencat 2.24 Marrëveshjet Erasmus+</i> <i>Evidenca 2.56 Tabelat përmbledhëse</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e	Në drejtim të integritetit të praktikës profesionale dhe të kërkimit në kurrikul, Albanian University ka nënshkruar marrëveshje me institucione publike, kompani dhe struktura të administratës shtetërore, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, ku studentët marrin trajnime konkrete dhe certifikime pas përfundimit të praktikës. Gjithashtu, universiteti ka strukturuar dhe zbatuar procedura të brendshme për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e praktikave, të përcaktuara në Rregulloren e Praktikës Profesionale, çka garanton transparencë dhe përgjegjësi të ndarë qartë ndërmjet studentëve, mentorëve akademikë dhe institucioneve pritëse. Veçanërisht pozitiv është edhe përfshirja e studentëve në programe ndërkombëtare si kursi i verës në Sapienza “Democracy, Electoral Processes and the Protection of

kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Individual and Collective Rights in the Contemporary Era”, i cili demonstroi lidhjen midis studimeve teorike dhe përvojës praktike ndërkombëtare. <i>Evidenca. 2.23 Mobilitet Studenti Erasmus;</i> <i>Evidenca 2.18 Rregullore e Praktikës Profesionale;</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në lidhje me vlerësimin periodik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, është evidentuar se Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative harton në fund të çdo viti akademik raporte analitike mbi ndikimin e këtyre bashkëpunimeve në arritjen e objektivave të programit. Raportet përmbajnë vlerësime mbi efektivitetin e praktikave, reagimet e institucioneve pritëse, si dhe sugjerime për përmirësimin e bashkëpunimit. Kjo praktikë e vlerësimit të vazhdueshëm është një element që tregon pjekuri institucionale dhe kulturë të cilësisë, pasi lidh drejtpërdrejt rezultatet e të nxënësve me ndikimin e bashkëpunimeve ndër-institucionale. <i>GVJ sugjeron që në të ardhshmen të forcohet dimension i kërkimor i bashkëpunimeve ndërkombëtare, nëpërmjet nismave të përbashkëta kërkimore dhe publikimeve të stafit akademik me partnerët e huaj.</i> <i>Gjithashtu, sugjerohet që të zgjerohet dokumentimi mbi ndikimin afatgjatë të këtyre bashkëpunimeve, veçanërisht në aspektin e punësimit të studentëve dhe zhvillimit të tyre profesional pas diplomimit.</i> <i>Evidenca 2.20 Raport mbi marrëveshjet</i>
Konkluzione	Institucioni siguron menaxhim të qëndrueshëm dhe funksional të programit përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative dhe strukturave drejtuese të universitetit, siç dëshmohet në raportet vjetore dhe vendimet e asamblesë akademike. Programi mbështetet në një rrjet aktiv partneritësh kombëtarë e ndërkombëtarë, përfshirë bashkëpunimet me Sapienza Università di Roma, Università degli Studi di Salerno, dhe Ministrinë e Drejtësisë, që kanë prodhuar rezultate konkrete në mobilitete, praktika profesionale dhe përvoja ndërkombëtare të



	studentëve. Mekanizmat e brendshëm të monitorimit dhe raportimit sigurojnë ndjekje të vazhdueshme të efektivitetit të këtyre marrëveshjeve dhe ndikimit të tyre në cilësinë e programit. <u>GVJ sugjeron që në të ardhshmen të forcohet dimension i kërkimor i bashkëpunimeve ndërkombëtare, nëpërmjet nismave të përbashkëta kërkimore dhe publikimeve të stafit akademik me partnerët e huaj.</u> <u>Gjithashtu, sugjerohet që të zgjerohet dokumentimi mbi ndikimin afatgjatë të këtyre bashkëpunimeve, veçanërisht në aspektin e punësimit të studentëve dhe zhvillimit të tyre profesional pas diplomimit.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të	GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi” është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit ka një kohëzgjatje normale 5 vjetore dhe në total 300 kredite (60 ECTS për vit akademik). <i>GVJ konstaton se lënda “E drejtë Penale” e cila zhvillohet në vitin e dytë akademik ka një peshë prej 16 ECTS, çka referon në</i>

Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<i>një ngarkesë të lartë mësimore për një lëndë në vit akademik si për studentët ashtu edhe për stafin akademik.</i> Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e mbrojtjes së diplomës me temë. <i>VKM nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar, VKM Nr. 879, date 18.12.2019</i> <i>Evidenca 3.03 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.60 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	GVJ konstaton se programi i studimit synon të formojë kompetenca akademike dhe profesionale në fushën e së drejtës, duke kombinuar mësimdhënie teorike, punë individuale dhe praktikën. Nëpërmjet këtij program studimi synohet të krijohet mundësia e formimit të shprehive bazike dhe të thelluara në të drejtën në përgjithësi si dhe në degë të veçanta të saj si dhe të zhvillojnë më shumë aftësitë kërkimore, përfshirë edhe aftësinë për të transferuar njohuritë e përfituara në praktikë. <i>Evidenca nr. 3.01 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca nr. 3.03 Plani Mësimorë</i> <i>Evidenca nr. 3.08 Programet mësimore</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në planin mësimor të programit të studimit evidentohet se praktika profesionale ka 12 ECTS dhe detyrimet përmbyllëse (Diploma) ka 13 ECTS. Kjo ndarje përkon me parashikimet ligjore në fuqi. GVJ gjatë shqyrtimit të planit mësimor të programit të studimit konstaton se praktika profesionale zhvillohet në vitin e 5 akademik dhe është e ndarë në dy semestra me ngarkese mësimore respektivisht njësoj me 132 orë në auditor dhe 18 orë jashtë auditorit.



	<i>GVJ rekomandon që praktika profesionale të zhvillohet në mjedise profesionale në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni apo fakulteti ka lidhur me institucione/zyra apo qendra që ofrojnë shërbime juridike. Lënda e Praktikës Profesionale duhet të riorganizohet në mënyrë që të përfshijë një ngarkesë më të madhe orësh jashtë auditorit, dhe një pjesë orësh të strukturuar të zhvillohen brenda auditorit sipas parashikimeve të njësisë përgjegjëse.</i> <i>Evidenca 3.03 Plani Mësimorë</i> <i>Evidenca 3.08 Programi i praktikës profesionale</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A

Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se programi i studimit zhvillohet me kohë të plotë në 5 vite akademike. Në bazë të evidencave konstatohet se IAL ofron mbështetje ekonomike për studentët që kanë arritur rezultate të shkëlqyera si dhe studentët me status “në nevojë”. Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, Albania University ka ofruar bursa dhe për fëmijët e policëve të rënë në detyra. AU nuk gëzon status të veçantë në kuptimin e kuadrit ligjor në fuqi. www.albaniauniversity.edu.al/sq/bursat/.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Ky program studimi është program i integruar 5 vjecar dhe nuk është vazhdim i një program të mëparshëm studimi. GVJ konstaton se Programi i Integruar i studimeve të Ciklit të Dytë në "Drejtësi" është i ngjashëm në masën 70% me programet e tjera të të njëjtit cikël studimi të ofruara nga universitetet publike dhe private në vend. Kjo përshtatje mundëson transferimin e studimeve të studentëve brenda vendit, por dhe jashtë vendit meqenëse lëndët janë të organizuara në bazë të krediteve të transferueshme evropiane ECTS. <i>Evidenca 3.03 Plani Mësimorë</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ konstaton se kodifikimi i programit është realizuar në përputhje me udhëzimet e MAS, me kodin 75MI0421S. <i>Evidenca nr. 2.14 Shkresa me kodet e propozuara nga AU për kodifikimin e programeve të studimit</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N / A



Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe evidencave, GVJ konstaton se programi i studimit respekton:</i> - Kornizën ligjore kombëtare për arsimin e lartë; - Sistemin Evropian të Krediteve (ECTS); - Rregulloret institucionale dhe aktet nënligjore përkatëse; <i>GVJ sugjeron që zhvillimi i praktikës profesionale të zhvillohet në mjedise profesionale në përputhje me marrveshjet e bashkëpunimit që institucioni apo fakulteti ka lidhur me institucione/zyra apo qendra që ofrojnë shërbime juridike. Lënda e Praktikës Profesionale në programin mësimor duhet të riorganizohet në më shumë orë (ngarkesë mësimore) jashtë auditorit dhe disa orë sipas parashikimeve të njësisë kryesore në auditor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2		
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.		
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve	
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko Administrative (DSHJPA) është njësia bazë përgjegjëse për zbatimin e programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi”. Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në përbërjen e tij tre departamente:	
	1. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes; 2. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme; 3. Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative;	
	Në vitin akademik 2024 – 2025 në Fakultetin e Shkencave Shoqërore janë angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë me kualifikimin si më poshtë:	
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Shoqërore	
	PAE	PAK

	Prof.Dr	2	3
	Prof.Asoc	8	9
	Dr/PhD	22	13
	Msc	2	13
	Gjithsej	34	38

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative përgjegjës për programin e studimit për tre vite akademike ka përbërjen si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	1	1	1
Prof. Asoc.	3	4	2	6	1	3
Dr./PhD.	7	14	7	8	10	9
Msc.	3	8	3	6	2	6
Totali	14	27	13	21	14	19

Evidenca_Tabela permbledhese

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nga shqyrtimi i dosjes, vizitës në institucion dhe takimit me studentët, GVJ-ja evidentoi se Departamenti angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin e procesit mësimor, duke përfshirë edhe stafin ndihmës akademik për të siguruar mbarëvajtjen e aktiviteteve mësimore në tërësi. Në Fakultetin e Shkencave Shoqërore janë të punësuar 7 personel ndihmës-akademik, të cilët mbështesin stafin akademik dhe studentët gjatë realizimit të proceseve akademike.
	Evidenca 2.53 Tabelat Përmbledhëse
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse	GVJ në bazë të evidencave të paraqitura nga GVB konstaton se ky program studimi nuk ka një koordinator të përcaktuar që në

për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<i>fillimet e tij. Evidenca që i është bashkëlidhur këtij Raporti reflekton një vendim për përcaktimin e koordinatorit të programit të studimit dhe të grup lëndëve për vitin akademik 2024-2025. Ky konstatim është bërë nga GVJ në bazë të dokumentacionit të paraqitur.</i> <i>Evidenca 2.15 Vendim caktimi koordinatori</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Drejtësi” organizohet duke respektuar kornizën normative kombëtare përkatëse për arsimin e lartë.</i> <i>Lëndët janë të kategorizuara sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi (kategorizimi A-E.)</i> <i>Nga shqyrtimi i evidencave përkatëse GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi plotëson kriterin 7 pedagogë efektiv për departament dhe të paktën 3 me tituj dhe grada.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e këtij program studimi është DSHJPA, e cila disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për strukturën dhe programin e studimit. Njësia kryesore organizon programin e studimit në bazë të akteve nënligjore të brendshme si: - Rregullore e DSHJPA; - Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Drejtësi”;

	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit ka të angazhuar gjithsej në vitin e fundit akademik 2024-2025: - 17 PAE; - 14 PAK; Me kualifikime si “Prof.Dr”, “Prof.As.Dr., “Dr. dhe “Msc”. Sa më sipër rezulton se fakulteti përmbush detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi sa i përket numrit të stafit akademik efektiv për departament por duhet të ketë në vëmendje të tij se për këtë program studimi stafi akademik i angazhuar duhet të gëzoj të paktën gradën shkencore “Dr.”. GVJ konstaton se program i studimit “Master Shkencave” në “Drejtësi” organizohet në 5 vite akademike të ndarë në 10 semestra. <i>Evidenca 2.53 Tabelat Përmbledhëse</i> <i>Evidenca Rregullore DSHJPA</i> <i>Evidenca Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Drejtësi” bazohet në aktet e brendshme të institucionit dhe është i strukturuar sipas sistemit ECTS. Kurrikula përfshin lëndë semestrale dhe të ndara në dy semestra me ndarje të qarta të orëve në auditor dhe jashtë tij. Lëndët kryesore si e “Drejta Civile”, “E Drejtë Kushtetuese”, “Procedure Civile”, “Procedurë Penale” por dhe lëndë të tjera zhvillohen në dy semestra duke siguruar thellim të njohurive teorike dhe praktike. Plani mësimor i programit të studimit përmban të gjitha elementët specifikues për lëndët, kreditet përkatëse, ngarkesën mësimore dhe ndarjen semestrale. <i>Evidenca 3.03 Plani mësimor</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Rregullime të përgjithshme për të gjitha programet e studimit të ofruara nga AU për procedurat e mësipërme gjenden vetëm në dispozita 49-50 të Rregullores së përgjithshme të institucionit. Gjithashtu dhe në Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve nuk rezulton një procedurë e vecantë për këtë program studimi. <i>Evidenca 1.02 Rregullore e Përgjithshme e AU</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e regjistrimeve dhe transferimeve</i>

Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	GVJ konstaton që programi i studimit është pajisur me syllabuset përkatëse për çdo lëndë/modul të programit. Syllabuset përmbajnë të gjitha elementët ligjor të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse si informacion i detajuar mbi lëndët, orët mësimore, ndarjen e tyre në leksion dhe seminarë, numri i krediteve, objektivat e lëndës, metodologjia, format e vlerësimit, frekuentimi. <i>GVJ konstaton se në disa raste syllabuset e lëndëve kanë titullar lënde staf akademik kualifikimi i të cilëve nuk përputhet me disiplinën përkatëse si psh në rastin e: Pedagogu L.H (me studime të orientuara kryesisht në të drejtën civile i ngarkuar me lëndë të disiplinës civile, publike dhe penale, Pedagogu G.GJ (me studime të orientuara specifikisht në të drejtën publike dhe marrëdhënie ndërkombëtare e ngarkuar me lëndën Procedurë Penale), etj.,</i> <u>GVJ rekomandon:</u> -që nga institucioni të mbahet në konsideratë përputhja e kualifikimit specifik të pedagogut (në përputhje me fushën e studimit në bazë të diplomave gradave dhe titujve akademik të fituara prej tyre) gjatë ndarjes së ngarkesës mësimore - që korniza normative e përfshirë në zërin "literaturë e detyrueshme" të mos konsiderohet "literaturë." <i>Evidenca nr. 3.08 Planet mësimore të programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.08 Syllabuse</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	GVJ vëren se syllabuset e programit të studimit përditësohen rregullisht në fillim të çdo viti akademik nga titullarët e lëndëve, në përputhje me zhvillimet e literaturës bashkëkohore dhe kërkesat e tregut të punës. Pas rishikimit, ato miratohen dhe nënshkruhen nga titullari i lëndës dhe Përgjegjësi i Departamentit përkatës. Çdo syllabus përmban të gjithë elementët e detyrueshëm sipas kuadrit ligjor dhe akteve nënligjore përkatëse, duke përfshirë përshkrimin e hollësishëm të lëndës, ndarjen e orëve në leksione dhe seminare, numrin e krediteve, objektivat mësimorë, metodologjinë e zhvillimit, format e vlerësimit dhe kërkesat për frekuentim.



	<i>Evidenca 3.08 Syllabuse</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit "Master i Shkencave" në "Drejtësi" është i qartë dhe i detajuar. Kurrikula është e strukturuar dhe ofron informacion gjithëpërfshirës dhe të nevojshëm për aktorët e interesuar.</i> <i>Gjithashtu GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve kanë titullar lënde staf akademik kualifikimi i të cilëve nuk përputhet me disiplinën përkatëse.</i> <u><i>GVJ rekomandon:</i></u> - që nga institucioni të mbahet në konsideratë përputhja e kualifikimit specifik të pedagogut (në përputhje me fushën e studimit në bazë të diplomave, gradave dhe titujve akademik të fituara prej tyre) gjatë ndarjes së ngarkesës mësimore - që korniza normative e përfshirë në zërin "literaturë e detyrueshme" të mos konsiderohet "literaturë."			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit është i qartë dhe përputhet me objektivat akademike dhe profesionale të tij si dhe reflekton qartësisht fushën e studimit që mbulon. Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Drejtësi" ofruar nga Albania University ofri një kurrikul gjithëpërfshirëse në drejtësi, çka i mundëson studentëve mundësinë për të vijuar avancim akademik dhe profesional të tyre. Objektivat e përgjithshëm të programit të studimit bazuar në aktet nënligjore të brendshme rezultojnë: - Programi ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e AU. Gjithashtu ky program studimi përputhet me misionin e

	pergjithshëm të arsimit të lartë në Shqipëri sipas specifikimeve në Ligjin nr. 80/2015. - Programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik në vënd dhe nuk bie ndesh me interes dhe vlerat kulturore. - Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. <i>Evidenca "Rregullore e Programit të Studimit"</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Sipas planit mësimor, Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave" në "Drejtësi" realizohet me 300 kredite, me kohë të plotë me kohëzgjatje 5 vite akademike të shpërndarë në 10 semestra. Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve në vite akademike dhe semestrale vlerësohet me kredite dhe orë mësimore përkatëse. GVJ konstaton nga shqyrtimi i planit mësimor se një disiplinë ka më shumë kredite nga të gjitha disiplinat me peshë të ngjashme me të (E drejta penale – 16 ECTS) <i>GVJ sugjeron që Lënda "E drejta e Detyrimeve" e cila zhvillohet në vitin e tretë akademik të zhvillohet në vitin e dytë akademik si vijë mësimi e lëndës "E drejta Civile". Në planin mësimor të programit të studimit "Master i Shkencave në "Drejtësi" në vit të dytë nuk ka asnjë lëndë të profilit civil/privat cka krijon boshllik dhe harresë tek studenti;</i> <i>GVJ rekomandon që në vijim të bëhet një ndryshim në planin mësimor me qëllim përvetësimin sa më të mirë të njohurive që ofron një disiplinë përkatëse gjithashtu dhe shpërndarjes sa më efektive të ngarkesës mësimore respektivisht:</i> ➤ Lënda "E drejta Penale" e cila zhvillohet në vit të dytë në të dy semestrat (e ndarë në E drejtë Penale të përgjithshme dhe E drejtë Penale të posacme) me një ngarkesë prej 16 ECTS në një vit akademik, rekomandojmë të ndahet në dy vite akademike. Kjo për shkak të volumit të lartë të ngarkesës mësimore por edhe rëndësisë që ka kjo lëndë në formimin e studentit në këtë program studimi;



	Ev. Tabela përmbledhëse																
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit i përket kornizës 7 të KSHK, si program i integruar i studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Drejtësi". Nga gjithsej 7,500 orë të programit, 2992 orë zhvillohen në auditor, duke përbërë 39.9% të ngarkesës totale, ndërsa 4508 orë (60.1%) i përkasin studimit individual jashtë auditorit. Struktura e këtij programi është projektuar për të mundësuar mobilitet të lehtë të studentëve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar. Në nivel kombëtar, mobiliteti mbështetet nga përputhshmëria ligjore e programit me programe të ngjashme të ofruara nga universitetet e tjera në vend, duke lehtësuar transferimin e krediteve dhe vazhdimësinë e studimeve. Ev. Tabela përmbledhëse																
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Disiplinat janë të organizuara në kategori sipas klasifikimit A, B, C, D dhe E në përputhje me përqindjet e përcaktuara në VKM Nr. 879/2019. Disiplinat përfshijnë formën e orëve mësimore Leksion/Seminar ku kombinohen elementë teorike dhe praktikë. Raporti i lëndëve teorike me ato praktike është i përshtatshëm për këtë program studimi dhe në përputhje me objektivat e tij. Struktura e këtij programi studimi është projektuar në mënyrë të tillë që të mundësoj mobilitetin e studentëve brënda dhe jashtë vëndit pasi programi i tij është i përafërt me programet simotra të studimit. Sipas kurrikulës së programit të integruar të studimit “Master i Shkencave” në “Drejtësi” lëndët ndahen në: <table><tr><th>Kategoria</th><th>Tipi i komponentit mësimor</th><th>VKM 41/2018 i ndryshuar</th><th>Programi i studimit</th></tr><tr><td>A</td><td>Lëndë bazë</td><td>15%-20%ECTS</td><td>19.3%</td></tr><tr><td>B</td><td>Lëndë karakterizuese</td><td>45%-55% ECTS</td><td>54.7%</td></tr><tr><td>C</td><td>Lëndë ndërdisiplinore/integruese</td><td>12%-15% ECTS</td><td>13.7%</td></tr></table>	Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	VKM 41/2018 i ndryshuar	Programi i studimit	A	Lëndë bazë	15%-20%ECTS	19.3%	B	Lëndë karakterizuese	45%-55% ECTS	54.7%	C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	12%-15% ECTS	13.7%
Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	VKM 41/2018 i ndryshuar	Programi i studimit														
A	Lëndë bazë	15%-20%ECTS	19.3%														
B	Lëndë karakterizuese	45%-55% ECTS	54.7%														
C	Lëndë ndërdisiplinore/integruese	12%-15% ECTS	13.7%														

	D	Lëndë plotësuese	6%-8% ECTS	8%
	E	Detyrime përmbyllëse	3%-5% ECTS	4.3%
<i>Ev. Tabela përmbledhëse</i>				
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ konstaton se syllabuset e programit të studimit përditësohen çdo vit akademik nga titullari i lëndës në përputhje me përditësimin e literaturës përkatëse dhe nevojave të tregut të punës. Syllabuse miratohen dhe firmosen nga titullari i lëndës dhe Përgjegjësi i Departamentit përkatës. Syllabuset përmbajnë të gjitha elementët ligjor të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse si informacion i detajuar mbi lëndët, orët mësimore, ndarjen e tyre në leksion dhe seminarë, numri i krediteve, objektivat e lëndës, metodologjia, format e vlerësimit, frekuentimi. <i>Evidenca nr. 3.08 Planet mësimore të programit të studimit</i>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Ky program studimi i nivelit 7 të KSHK ofron studentëve njohuri të thelluara në fushën e së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për studentët. Stafi akademik aplikon metodologji bashkëkohore që siguron përvetësimin e njohurive akademike dhe shkencore nga studentët. <i>Evidenca nr. 3.08 Planet mësimore të programit të studimit</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Drejtësi” ofruar nga Albania University ofron një kurrikul gjithëpërfshirëse në drejtësi, çka i mundëson studentëve mundësinë për të vijuar avancim akademik dhe profesional të tyre. Kurrikula e programit të studimit ofron njohuri të thelluara në të drejtën civile, të drejtën penale, të drejtën publike, të drejtën tregtare etj duke u përshtatur me kërkesat profesionale dhe akademike. <i>Evidenca nr. 3.08 Planet mësimore të programit të studimit</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se programi i studimit përfaqëson një kurrikul gjithëpërfshirëse që ndihmon studentit për vijëmesinë e studimeve të mëtejshme si dhe për tregun e punës. Ky program është i strukturuar në përputhje me legjislacionin në fuqi duke përfshirë 10 semestra akademike në 5 vite me gjithësej 300 ECTS, ku secili vit përmban 60 ECTS.			

	<i>Ky program studimi ofron njohuri të thelluara në fushën e së drejtës dhe lejon studentët të ndërthurin dijet teorike me ato praktike duke iu përshtatur objektivave arsimore përkatëse.</i> <i>GVJ rekomandon që lënda “E drejta Penale” e cila zhvillohet në vit të dytë në të dy semestrat (e ndarë në E drejtë Penale të përgjithshme dhe E drejtë Penale të posacme) me një ngarkesë prej 16 ECTS në një vit akademik, rekomandojmë të ndahet në dy vite akademike. Kjo për shkak të volumit të lartë të ngarkesës mësimore por edhe rëndësisë që ka kjo lëndë në formimin e studentit në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Ky program studimi është hartuar në bazë të një studimi në nivel kombëtarë të të gjithë programeve të studimit PIND të ofruara në Drejtësi në Republikën e Shqipërisë, duke unifikuar në masën 70% të planit mësimor me të gjitha institucionet e tjera ofruese të këtij programi studimi. Në bazë të evidencave rezulton se program rishikohet dhe përditësohet vazhdimisht duke përfshirë përditësimin e lëndëve, syllabusve dhe literaturës për ti përshtatur e zhvillimet më të fundit në fushën e së drejtës dhe legjislacionit. Në nivel institucional dhe njësie përgjegjëse funksionojnë komisione të specializuara për sigurimin e cilësisë dhe monitorimin e zhvillimeve të programit duke marrë në konsideratë edhe mendimet e tregut të punës, stafit akademik dhe studentëve. Ky mekanizëm synon dhe garanton qëndrueshmërinë dhe konkurrencën në tregun e arsimit të lartë në mënyrë që program të jetë i përshtatshëm për sfidat praktike dhe teorike të profesionit duke përgatit studentët për një treg pune në ndryshim të vazhdueshëm.


	<i>Evidenca 1.03 Strategjia për zhvillimin institucional</i> <i>Evidenca 1.08 Strategjia e SBC</i> <i>Evidenca 2.13 Studimi i tregut</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Gjatë shqyrtimit të evidencave dhe vizitës në institucion rezulton se institucioni përfshin studentët në struktura të ndryshme vendimarrëse të IAL duke kërkuar vazhdimisht mendimin/rekomandimet dhe sygjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Aktivizimi i studentëve konstatohet përmes përfaqësimit të tyre në organe si: Senati Akademik, Këshilli Etikës si dhe në procedura të tjera specifike sic është dhe hartimi i Raportit të Brendshëm të Cilësisë. Studentët me mesatare të lartë përfshihen gjithashtu në aktivitete të tjera akademik, sportive dhe kulturore të institucionit, si psh: aktivitete kërkimore dhe akademike, projekte, botime, konferenca, workshope, aktivitete sportive, etj, cka i ndihmon ato në zhvillimin personal dhe profesional të tyre. <i>Evidenca 1.25 Manuali i studentëve</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Drejtësi” i nënshtrohet akreditimit për herë të parë. Megjithatë nga vizita në institucion dhe intervistat e bera me aktorët e angazhuar në këtë program studimi konstatohet se njësia përgjegjëse për këtë program angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e së drejtës. Ky process mbështet në bashkëpunime të ngushta me aktorë të ndryshëm si rrjete profesionistësh, institucione, shoqata dhe organizata të fushës me qëllim sigurimin e një lidhje të fortë ndërmjet programit dhe kërkesave të tregut të punës. Përmesë këtyre bashkëpunimeve të cilat disa prej tyre janë sanksionuar dhe në marrëveshje apo MoU sigurohet që program i studimit të përshtate me sfidat dhe nevojat aktuale duke garantuar që studentët të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të qënë konkurrues. <i>Evidenca 1.30 Marrëveshje bashkëpunimi</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton AU si dhe njësia përgjegjëse e programit të studimit ka një bashkëpunim të ngushtë me partnerë të</i>

	dimensioneve të ndryshme për realizimin e objektivave dhe nevojave që paraqëet program. Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Drejtësi" dëshmon një angazhim të qëndrueshëm për përmirësimin dhe përditësimin në përputhje me kërkesat dinamike të tregut të punës dhe zhvillimet shkencore dhe legislative në fushën e së drejtës. Institucioni ka krijuar hapsira konkrete për pjesëmarrjen e studentëve në organet vendimarrëse dhe veprimtari të tjera institucionale si akademike, kulturore e sportive duke nxitur një kultur bashkëpunuese ndërmjet këtyre të fundit dhe institucionit. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm të fushës të së drejtës përbën një vlerë të shtuar për programin. Këto bashkëpunimi ndihmojnë në përmirësim e vazhdueshëm të programit të studimit dhe përshtatjen sa më të mirë të tij me kërkesat e tregut të punës.			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ konstaton që në rregulloren e DSHJPA përcaktohen qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të kërkimit shkencor. Këto objektiva janë në përputhje me objektivat madhore të institucionit. Programi synon formimin e profesionistëve të rinj në fushën e drejtësisë duke u ofruar atyre një bazë studiore teorike, kërkimore dhe praktike. <i>Evidenca nr. 1.12 Strategjia e Kërkimit Shkencor 2025-2028</i> <i>Evidenca 1.13 Raport i veprimtarisë kërkimore shkencore ZKKSHBA</i> <i>Evidenca Rregullorja e DSHJPA</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë	GVJ konstaton se DSHJPA si njësi bazë dhe përgjegjëse e këtij programi studimi inkurajon dhe mbështet stafin akademik që të marrin pjesë në leksion të hapura, projekte kërkimore, iniciativa të tjera me karakter shkencor duke nxitur zhvillimin profesional dhe avancimin e njohurive në fushën akademike.



kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<i>Evidenca nr. 2.10.1 Programi vjetor të veprimtarisë mësimore dhe shkencore të FSHSH</i> <i>Evidenca 2.31 Trajnime/aktivitete DSHJPA</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	GVJ konstaton se studentët e këtij programi studimi inkurajohen të angazhohen në projekte të ndryshme si Erasmus +, shkolla verore, workshope etj. Studentët nxiten të, arrin pjesë në trajnime dhe leksione të hapura apo konkurse të ndryshme kombëtar dhe ndërkombëtare që zhvillohen <i>Evidenca nr. 2.23 Praktikë dokumentacioni i mobilitetit të studentit në kuadër të Erasmus +</i> <i>Evidenca nr. 2.32 Aktivitete të ndryshme studentore</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Nga dokumentacioni i paraqitur por edhe nga intervistat e bëra me stafin akademik rezulton që instucioni mbështet financiarisht të gjitha njësitë bazë në zhvillimin e aktivitetëve kërkimore dhe shkencore duke ofruar fonde specifike për realizimin e projekteve studimore, kërkimore dhe shkencore dhe botimet e tyre me Scopus, të cilat rezulton se financohen plotësisht nga AU duke i shtuar vlerës së plotë të financuar dhe një bonus prej 30% në formë shpërblimi. <i>Evidenca nr. 1.27 Miratimi i fondit për punë shkencore</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se program i studimit "Master i Shkencave" në "Drejtësi" është bazuar mi studimin e tregut të punës dhe si rrjedhojë paraqet siguri, qëndrueshmëri dhe efikasitet. Programi ka si objektiv të përcaktuar studentët me njohuri të thelluara dhe bashkëkohore në fushën e së drejtës. Programi i studimit është i përshtatur me objektivat strategjik të institucionit të cilat lidhen me zhvillimin akademik dhe shkencor të përfutuesve të programe të studimit të ofruara nga AU.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Në bazë të dokumentacionit të depozituar nga GVB rezulton që grupet lëndore gezojnë mbështetje nga njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, duke garantuar bashkëpunim brënda strukturave të institucionit por dhe ndërinstitucional. Ky pohim u bë nga vet stafi akademik gjatë vizitës në institucion. <i>Evidenca nr. 2.11_Plani i veprimtarive vjetore të DSHJPA</i> <i>Evidenca nr. 2.31_Trajnime aktivitete</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga intervistat me stafin akademik dhe dokumentacioni i depozituara GVJ konstaton se njësia përgjegjëse e programit të studimit angazhon stafin akademik në projekte me karakter kërkimor shkencor (sic është bashkëpunimi ndërmjet AU dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave) por në të njëjtën kohë ndihmon studentët të përfshihen në këtë proces. <i>Evidenca nr. 2.21_Projekte të zbatuara dhe në process në kuadër të kërkimit shkencor</i> <i>Evidenca nr. 2.25_ Të dhënat për financimin e studentëve të programit për aktivitetet kërkimore shkecore</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se në Konferencat Shkencore stafi akademik i programit të studimit ka përfshirë dhe studentët si bashkëautor të tilla si: - Për punime shkencore individuale të pedagogëve 23 studentë; - Për projekte shkencore në rang Departamenti 10 studentë; - Për projekte shkencore në rang Fakulteti 5 studentë; -Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë 3 studentë; Studentët realizojnë kërkime të cilat do ti ndihmojnë në punimin e Mikrotezës por edhe në hulumtimet e tyre studimore.

	<i>Evidenca 2.72 Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë në tre vitet e fundit (Tabela 22)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	GVJ konstaton nga plani mësimor që programi i studimit plotëson standardet normale për krijimin e profesionistëve për tregun kombëtarë të punës. Qëllimi i programit të studimit realizohet me anë të lëndëve/moduleve, analizës së tregut të punës dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione private dhe publike në fushën e së drejtës. Gjithashtu ky program studimi garanton dhe mobilitetin e studentëve në bazë të marrëveshjeve Erasmus + të lidhura ndërmjet AU dhe institucioneve simotra jashtë vendit. Megjithatë konstatohet nga analiza e Planit Mësimor se ky i fundit ka një % shumë të vogël të lëndëve dhe normës mësimore për disiplina me karakter ndërkombëtar. <i>Evidenca 2.53 Tabela përmbledhëse</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nga evidencat e depozituara nuk rezulton asnjë dokument specifik nga shoqata dhe rrjete profesionale që kanë dhënë rekomandimet e tyre për planin mësimor.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	GVJ konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave” në “Drejtësi” zhvillohet në përputhje me aktet ligjore kombëtare dhe siguron që studentët të pajisen me aftësitë e nevojshme për të ushtruar profesionin e juristit në disa dimensione si atj të avokatit, noteris, ekspertit ligjor, këshilltarit ligjor, etj.

Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni është i vëmendshëm ndaj përditësimeve në fushën e së drejtës si dhe kërkesave të tregut të punës. Kjo bazuar në analizën e tregut të punës të hartuar nga institucioni por edhe të një sërë marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura ndërmjet tij dhe aktorëve të tjerë me rëndësi në fushën e së drejtës në vënd.</i> <i>Gjithashtu konstatohet se institucioni angazhon dhe inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në aktivite të ndryshme akademike, kërkimore apo projekteve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.</i> <i>Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Drejtësi" zhvillohet në përputhje me aktet ligjore kombëtare dhe siguron pajisjen e studentëve me aftësi të nevojshme për të ushtruar profesionin e tyre në të gjitha dimensionet e së drejtës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikën	Programi i studimit PIND ka një proces të diversifikuar të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke kombinuar forma të ndryshme të transmetimit të dijeve: leksione, seminare, punë laboratorike, detyra kursi/ese, projekte dhe praktika profesionale. Këto forma janë të përcaktuara në rregulloren e programit dhe syllabus-in e çdo lënde. Personeli akademik i ofron studentëve mundësi të zhvillojnë aftësi praktike dhe

profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	profesionale përmes institucioneve publike dhe private përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit të studimit, Neni 7, 8</i> <i>Evidenca 3.08 Syllabuset e lëndëve të programit</i> <i>Evidenca 2.16 Dokumentacioni i praktikave profesionale</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Stafi akademik respekton larminë dhe nevojat individuale të studentëve, duke ofruar metoda alternative dhe fleksibile mësimdhënieje. Ai përdor mjete dixhitale (Microsoft Teams, Google Classroom) për shpërndarjen e materialeve, komunikim dhe vlerësim të vazhdueshëm. Kjo qasje garanton lirinë akademike të pedagogut dhe rrit efektivitetin e mësimnxënies. <i>Evidenca 2.30 Vendimi i departamentit për miratimin/rishikimin e syllabus-ve</i> <i>Evidenca 1.31 Trajnime për stafin mbi metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies</i> <i>Evidenca 1.32 Manuali i përdorimit të Teknologjisë së Informacionit për mësimdhënie</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Institucioni mbështet zhvillimin profesional të stafit akademik duke ofruar trajnime të brendshme, mundësi mobiliteti ndërkombëtar dhe vizita studimore. Kjo siguron njohje të praktikave më të mira në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor. Politikat e zhvillimit profesional lidhen direkt me rezultatet e pritshme të të nxënës dhe standardet e programit. <i>Evidenca 2.22 Dokumentacioni i mobilitetit të stafit akademik</i> <i>Evidenca 1.31 Trajnime për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies</i> <i>Evidenca 2.31 Trajnime/aktivitetet e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies	Stafi akademik i angazhuar në mësim përdor metoda interaktive, diskutime, projekte grupore dhe simulime, duke nxitur mendimin kritik, autonominë dhe përgjegjësinë e studentëve. Ai siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit reciprok, duke kontribuar në zhvillimin profesional dhe personal të studentëve.

interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<i>Evidenca 2.69 Të dhëna mbi aktivitetin kërkimor të stafit akademik</i> <i>Evidenca 2.31 Trajnime/aktivitete DSHJPA</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti përgjegjës për programin e studimit kryen vlerësime periodike të metodave të mësimdhënies duke përfshirë studentët në vlerësimin e metodave të mësimdhënies përmes pyetësorëve dhe konsultimeve. Sugjerimet dhe feedbacku i studentëve reflektohen në rishikimin e syllabusve dhe metodave të mësimdhënies, duke siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. <i>Evidenca 1.33 Pyetësorë për studentët</i> <i>Evidenca 2.50 Raporti i vlerësimit të studentëve për VA 2023-2024</i> <i>Evidenca 1.05 Raporti vjetor i Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i> <i>Evidenca 1.30 Marrëveshje me EU for Innovation Hub Albania</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë	Institucioni ka struktura të dedikuara për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies (KVI, NJSBC), të cilat monitorojnë cilësinë, mbështesin eksperimente me metoda të reja dhe trajnime të stafit. Strukturat koordinojnë me departamentet dhe fakultetet për të siguruar që standardet e cilësisë të respektohen dhe të implementohen në praktikë. <i>Evidenca 1.09 Rregullore e Komisionit të Vlerësimit Institucional</i> <i>Evidenca 1.10 Manuali i Cilësisë</i> <i>Evidenca 1.07 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC</i> <i>Ev. 2.19 Format e raportimit të punës semestrale të stafit akademik</i> <i>Ev. 2.22 Dokumentacion i mobilitetit të stafit akademik</i>

vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<i>Ev. 1.31 Trajnime të stafit mbi metodat inovative</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në evidencat e konsultuara, Institucioni siguron një proces mësimdhënieje dhe mësimnxënieje të diversifikuar dhe me studentin në qendër, duke përdorur metoda tradicionale dhe inovative, përfshirë platforma dixhitale.</i> <i>Personeli akademik ka kompetencat dhe angazhim të vazhdueshëm, duke promovuar mendimin kritik, krijues dhe autonominë e studentëve. Procesi i vlerësimit dhe përmirësimit të metodave është i strukturuar dhe i vazhdueshëm, me mbështetje nga strukturat për sigurimin e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni ka zhvilluar rregullore dhe procedura të qarta për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore, të cilat janë publike, të njohura nga studentët dhe të zbatuara në mënyrë sistematike. Evidencat tregojnë se programi i studimit dhe syllabuset përcaktojnë qartë kriteret, metodologjitë dhe format e vlerësimit, duke përfshirë provime, detyra kursi, ese dhe projekte, si dhe pjesëmarrje aktive. AU ka përcaktuar qartë kriteret dhe mënyrat e vlerësimit në rregulloret e programit të studimit dhe syllabuset përkatëse. Studentët informohen për strukturën e studimit, format e mësimi dhe procedurat e vlerësimit që në fillim të vitit akademik. Ky nivel transparence ndihmon studentët të kuptojnë pritshmëritë dhe kriteret e suksesit akademik. <i>Evidenca 3.08 Syllabuset</i>

	<i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 2.07 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidenca 2.36 Formulari i vlerësimit të vazhduar</i> <i>Evidenca 2.65 Tabela e formatit të kontrollit</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Çdo syllabus i prezantohet studentëve dhe përmban informacion të detajuar mbi metodologjinë e vlerësimit, duke përfshirë provime, detyra, ese, prezantime dhe pjesëmarrjen në seminare në përputhje me VKM Nr. 41/2018, i ndryshuar. Kjo praktikë siguron qartësi dhe transparencë për studentët. <i>Evidenca 3.08 Syllabuset</i> <i>Evidenca 2.36 Formulari i vlerësimit të vazhduar</i> <i>Evidenca 2.65 Tabela e kontrollit</i> <i>Evidenca 2.40 Udhëzues didaktik</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi është gjithëpërfshirës dhe përfshin testime me shkrim, me gojë, projekte, ese, punë në grup etj. Pedagogët monitorojnë progresin akademik gjatë gjithë vitit akademik, duke siguruar që studentët të vërtetojnë kompetencat profesionale dhe shkencore të parashikuara. Ky kombinim metodash garanton një vlerësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës të studentëve. <i>Evidenca. 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 2.35 Format e provimeve</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara, GVJ konstaton se institucioni ka rregullore dhe procedura të qarta për testimin dhe vlerësimin e studentëve në syllabuset dhe rregulloret përkatëse. Metodologjia e testimit është transparente dhe përfshin forma të ndryshme të vlerësimit (provime, ese, detyra kursi, prezantime, punë grupi).</i> <i>Studentët njostohen në fillim të vitit akademik për mënyrën e vlerësimit. Institucioni ka marrë masa për parandalimin e plagjiaturës dhe kopjimit, dhe rezultati final bazohen në meritë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Institucioni siguron vlerësim objektiv dhe transparent, duke përfshirë përdorimin e sistemeve elektronike, mbikëqyrjen e provimeve, procedura të ankimimit dhe feedback individual për studentët. Procedurat janë të dokumentuara dhe të harmonizuara me rregulloret e brendshme. Institucioni ka vendosur një kombinim të vlerësimit të vazhduar (40%) dhe provimit përfundimtar (60%), duke siguruar që performanca e studentëve të vlerësohet gjatë gjithë vitit akademik. Teza dhe provimet miratohen dhe depozitohen sipas rregullave të programit. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 2.35 Format e provimeve</i> <i>Evidenca 2.65 Tabela 15</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	AU ka infrastruktura të përshtatshme dhe laboratorë kompjuterikë. Platforma online përdoret për disa lëndë, duke reduktuar mundësitë e abuzimit dhe rritur transparencën e procesit. <i>Evidenca 1.32 Manuali i IT</i> <i>Evidenca 2.67 Tabela e platformave online</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Pedagogët informojnë studentët mbi pikët e grumbulluara gjatë vitit në mënyrë transparente dhe të rregullt, duke komunikuar rezultatet e çdo komponenti të vlerësimit – përfshirë detyrat individuale, prezantimet, testet e ndërmjetme dhe pjesëmarrjen aktive në orë. Ky proces synon të garantojë që studentët të jenë të vetëdijshëm për ecurinë e tyre akademike dhe të kenë mundësi për përmirësim të vazhdueshëm përpara provimit përfundimtar. Provimi përfundimtar zhvillohet në kushte të standardizuara, me përdorimin e letrave të vulosura zyrtarisht nga institucioni



	dhe me verifikim të kujdesshëm të identitetit të çdo studenti, për të siguruar korrektësi dhe integritet në procesin e vlerësimit. Pyetjet dhe format e provimit përcaktohen në përputhje me rezultatet e të nxënit të parashikuara në syllabus dhe me natyrën e lëndës. Komisioni i provimit përbëhet nga pedagogë të kualifikuar. Komisioni garanton objektivitet, paanësi dhe vlerësim të drejtë për çdo student. Të gjitha fazat e procesit – nga shpërndarja e materialeve deri te dorëzimi i rezultateve përfundimtare – dokumentohen në mënyrë të plotë dhe ruhen sipas procedurave të përcaktuara në aktet rregullatore. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca. 2.35 Format e provimeve</i> <i>Evidenca 2.65 Tabela 15</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pedagogët vlerësojnë gjatë semestrit, përmes komenteve mbi detyrat me shkrim, prezantimet, pjesëmarrjen aktive dhe punën kërkimore të studentëve. Ky feedback është i orientuar drejt rezultateve të të nxënit dhe përmes këshillave praktike për mënyrën se si studentët mund të thellojnë njohuritë teorike, të përmirësojnë aftësitë analitike dhe të forcojnë kompetencat profesionale. Pas zhvillimit të provimeve përfundimtare, studentët kanë mundësi të konsultohen me pedagogun për të diskutuar rezultatin, për të kuptuar arsyet e vlerësimit dhe për të marrë sugjerime për përmirësim në lëndët e ardhshme. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	DSHPJA dhe stafi akademik ushtrojnë monitorim të vazhdueshëm gjatë zhvillimit të çdo aktiviteti vlerësimi, duke garantuar zbatimin e plotë të rregullave dhe standardeve të integritetit akademik. Gjatë provimeve, sigurohet prania e stafit përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit, përfshirë drejtues të departamentit dhe anëtarë të komisionit të provimit, të cilët mbajnë procesverbale dhe dokumentojnë çdo veprim. Në përputhje me Kodin e Etikës dhe rregulloret e programit të studimit, ndalohet rreptësisht përdorimi i çdo materiali ndihmës të paautorizuar ose çdo forme tjetër të sjelljes joetike, si kopjimi, komunikimi gjatë provimit apo përdorimi i pajisjeve elektronike.

	<i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 1.15 Kodi i Etikës</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Forma e vlerësimit zbatohet në mënyrë të objektive, transparente dhe të dokumentuar, në përputhje me rregulloret përkatëse të institucionit. Çdo provim ose komponent vlerësimi zhvillohet mbi bazën e kriterëve të qarta, të përcaktuara paraprakisht në syllabusin e lëndës dhe të njohura nga studentët që në fillim të semestrit. Rezultatet e provimeve dokumentohen në procesverbale zyrtare, të nënshkruara nga komisioni përkatës. Studentët kanë akses të plotë dhe të sigurt në rezultatet e tyre përmes sistemit elektronik “Pitagora”, i cili garanton transparencë dhe efikasitet në komunikimin e vlerësimeve. Për çdo paqartësi apo mospërputhje të mundshme, studentët kanë të drejtën të kërkojnë sqarime nga pedagogu brenda afateve të përcaktuara nga rregulloret, si dhe të kërkojnë rishikim të vlerësimit në përputhje me procedurat e parashikuara nga DSHPJA dhe Sekretaria Mësimore. <i>Evidenca 1.02 Rregullore e përgjithshme</i> <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 2.07 Rregullore e Fakultetit</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët gëzojnë të drejtën për të kërkuar rishikim të vlerësimit, në rast se konsiderojnë se rezultati i marrë nuk pasqyron realisht performancën e tyre gjatë provimit apo procesit mësimor. Kjo e drejtë ushtrohet në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në rregulloret përkatëse të fakultetit dhe të programit të studimit. Çdo kërkesë për rishikim depozitohet me shkrim pranë sekretarisë mësimore ose DSHPJAs dhe shqyrtohet nga komisioni i posaçëm i ngritur për këtë qëllim. Pas shqyrtimit, vendimi i komisionit i komunikohet studentit në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me afatet ligjore. <i>Evidenca 2.07 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i>

Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Procedurat e shqyrtimit të ankesave janë të qarta, transparente dhe të dokumentuara duke garantuar respektimin e parimeve të drejtësisë dhe paanësisë akademike. Çdo ankesë e paraqitur nga studenti regjistrohet në mënyrë zyrtare dhe trajtohet nga komisionet përkatëse në përputhje me rregulloren e fakultetit dhe afatet e përcaktuara. Vendimi i komisionit i komunikohet studentit brenda 5 ditëve nga shqyrtimi i kërkesës dhe konsiderohet përfundimtar, duke mbyllur procesin administrativ të ankesës. <i>Evidenca 2.07 Rregullore e Fakultetit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara konstaton se institucioni garanton një vlerësim të drejtë dhe transparent, duke përfshirë procedura të qarta për ankimimin dhe rishikimin e vlerësimeve. Testimi dhe vlerësimi realizohet gjatë gjithë vitit akademik, infrastruktura elektronike dhe komisionet e provimeve sigurojnë objektivitetin dhe besueshmërinë e rezultateve. Studentët kanë të drejtë të kërkojnë rishikim, dhe çdo procedurë dokumentohet dhe arkivohet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit është ndërtuar në përputhje me objektivat akademike dhe profesionale, duke garantuar thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të avancuara. Struktura e planit mësimor dhe përmbajtja e syllabuseve reflektojnë qartë rezultatet e të nxëniet dhe kompetencat që synohen të fitohen në përfundim të studimeve. Përfshirja e njohurive teorike dhe praktike siguron balancë ndërmjet aspektit akademik dhe përgatitjes profesionale të studentëve.

	<i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.08 Programet mësimore (syllabuset)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit siguron zhvillimin e aftësive të veçanta në fushat mbështetëse si teknologjia e informacionit, komunikimi profesional, aftësitë humane dhe sociale, si dhe njohuritë në gjuhë të huaj. Përmes përmbajtjes ndërdisiplinore dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies, studentët përvetësojnë kompetenca për përdorimin e burimeve digjitale dhe për komunikim institucional në kontekste kombëtare e ndërkombëtare. <i>Evidenca 3.04 – Kuadri i përgjithshëm i veprimtarive formuese të programit</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studentët analizohen në përfundim të çdo lënde përmes orëve përmbledhëse dhe raporteve vlerësuese. Procesi përfshin orientimin e studentëve për çështjet më të rëndësishme në provimin final. Departamenti realizon rishikim periodik të programit, syllabuseve dhe metodave didaktike, bazuar në analizën e rezultateve të të nxënit dhe raportet semestrale të pedagogëve. <i>Evidenca 2.30 Vendim departamenti për rishikimin e syllabuseve</i> <i>Evidenca 2.19 Raport semestral i pedagogut</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin	GVJ konstaton se mësimdhënia zhvillohet mbi bazë kompetencash, duke u fokusuar në nxitjen e mendimit kritik, punën në grup dhe integrimin e praktikës me teorinë. Studentët përfshihen në klinikën ligjore, simulime dhe vizita mësimore në institucione të drejtësisë, si Gjykata e Lartë. Programi përfiton nga bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar, i cili lehtëson mobilitetin dhe përvojën praktike të studentëve. <i>GVJ sugjeron që lidhja me tregun e punës dhe strukturat profesionale mund të institucionalizohet më tej në të ardhmen për të siguruar vazhdimësinë e praktikave profesionale.</i> <i>Evidenca 3.08 Programet mësimore (syllabuset)</i> <i>Evidenca 2.68 Format e kontrollit të njohurive</i>

e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<i>Evidenca 2.55 Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Evidenca 2.16 Dokumente për praktikat profesionale</i> <i>Evidenca 2.33 Vizita mësimore në Gjykatën e Lartë</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik është i angazhuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional përmes organizimit të orëve të hapura, seminareve dhe takimeve tematike, të cilat fokusohen në zhvillimet më të fundit shkencore, ligjore dhe teknologjike. Këto aktivitete organizohen si brenda programit të studimit, në kuadër të lëndëve mësimore, ashtu edhe jashtë tij, si pjesë e iniciativave të departamentit për të nxitur mësimdhënien bashkëkohore dhe ndërdisiplinare. Në këto veprimtari ftohen rregullisht pedagogë të ftuar, ekspertë të fushës së së drejtës, përfaqësues të institucioneve publike, të profesioneve të lira dhe të organizatave ndërkombëtare, të cilët ndajnë përvojat e tyre praktike me studentët. Kjo qasje krijon ura lidhëse midis teorisë dhe praktikës, duke forcuar përgatitjen profesionale të studentëve dhe duke i ekspozuar ata ndaj realiteteve aktuale të tregut të punës dhe zhvillimeve ligjore. <i>Evidenca 1.13 Raport i veprimtarisë kërkimore-shkencore</i> <i>Evidenca 2.31 Trajnime dhe aktivitete të Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	AU mbështet në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore të studentëve, duke krijuar mundësi konkrete për përfshirjen e tyre në jetën akademike dhe profesionale të universitetit. Përmes klubeve studentore, pjesëmarrjes në veprimtari kërkimore, si dhe financimit të projekteve dhe iniciativave studentore, universiteti nxit zhvillimin e aftësive kërkimore, kritike dhe inovative të studentëve. Studentët inkurajohen të marrin pjesë në konferenca, konkurse akademike, debate ligjore, punëtori dhe projekte kërkimore të përbashkëta me stafin akademik, duke kontribuar në zhvillimin e ideve të reja dhe në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e

	të kërkimit shkencor. Institucioni ofron mbështetje financiare dhe logjistike për pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me prioritetet e përcaktuara në dokumentet strategjike të universitetit. Strategjia e Zhvillimit Institucional 2023–2028 parashikon përfshirjen aktive të studentëve në jetën kërkimore dhe duke i orientuar ata drejt formimit profesional dhe zhvillimit të qëndrueshëm. <i>Evidenca 1.03 Strategjia për Zhvillimin Institucional 2023–2028</i> <i>Evidenca 2.32 Aktivitete të ndryshme të studentëve</i> <i>Evidenca 2.25 Të dhëna për financimin e studentëve në aktivitete shkencore;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive krijuese dhe zbatuese të studentëve, duke përmbushur objektivat akademike dhe profesionale në përputhje me profilin e drejtësisë.</i> <i>Metodat bashkëkohore të mësimdhënies, përfshirja e praktikës profesionale dhe integrimi i elementeve kërkimore e inovative tregojnë përmbushjen e kriteret të standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni ka hartuar dhe zbatuar një procedurë të posaçme që rregullon procesin e diplomimit të studentëve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe me kuadrin rregullator të brendshëm të universitetit. Kjo procedurë siguron që procesi të jetë transparent dhe i drejtë për të gjithë studentët. Rregullorja e programit të studimit dhe Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës përmbajnë qartësisht të gjitha hapat dhe afatet që duhet të ndiqen – nga zgjedhja e temës dhe miratimi i saj nga departamenti, te miratimi i udhëheqësit shkencor, dorëzimi i

	punimit, vlerësimi dhe mbrojtja përpara komisionit të diplomimit. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 2.29 Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët gjatë gjithë procesit të përgatitjes së diplomës. Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës dhe takimet periodike me udhëheqësin shkencor sigurojnë mbështetje metodologjike. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 2.29 Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i diplomimit përbëhet nga anëtarë të Departamentit, të cilët propozohen dhe miratohen në përputhje me procedurat institucionale të përcaktuara. Procesi i vlerësimit të njohurive mbulon të gjitha modulet e programit të studimit dhe zhvillohet mbi bazën e standardeve akademike të miratuara, duke siguruar objektivitet dhe vlerësim të drejtë të kompetencave të studentëve. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 2.29 Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë	Udhëheqësi i punimit të diplomës ka një rol kyç në orientimin dhe mbështetjen e studentit gjatë punimit të diplomes. Ai jep udhëzime për përzgjedhjen e temës, metodologjinë e kërkimit dhe strukturën e punimit, duke monitoruar progresin në mënyrë periodike dhe duke sugjeruar për përmirësime. Udhëheqësi miraton versionin final të punimit, duke garantuar që ai të plotësojë kriteret e cilësisë, rregullat formale dhe standardet akademike të institucionit. <i>Evidenca 2.29 Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës</i>

për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga intervistat me studentët dhe nga evidencat e konsultur GVJ konstaton se Institucioni siguron mbështetje për studentët në kryerjen e analizave dhe kërkimeve përmes marrëveshjeve me institucione partnere. <i>Evidenca 2.52 Marrëveshje për programin</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Procesi i vlerësimit të diplomës është i përcaktuar qartë në aktet rregullatore të institucionit. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e vlerësimeve të anëtarëve të komisionit ad hoc të diplomimit. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 2.29 Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët që përfundojnë studimet pajisen me diplomë dhe suplement të diplomës. Suplementi i diplomës përmban informacion të detajuar mbi programin e studimit. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit</i> <i>Evidenca 2.29 Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës</i> <i>Evidenca 2.29.2 Suplementi i Diplomës</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria Mësimore ruan dhe administron dokumentacionin e studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të dhënat janë të arkivuara dhe të aksesueshme për studentët ose autoritetet përkatëse sipas procedurave të përcaktuara. <i>Evidenca 1.16 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 2.71 Cilësia në hyrje dh në dalje e studentëve</i> <i>Evidenca 2.73 Numri i studentëve të diplomuar</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka një kuadër të qartë rregullator dhe implementues për realizimin e detyrimeve përmbyllëse të</i>

	<i>programit të studimit duke asistuar studentët, me rregullore dhe udhëzues të mirëstrukturuar dhe me angazhim aktiv të stafit akademik dhe administrative.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në	Nuk aplikohet



dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1										
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.										
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve									
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë	GVJ konstaton që personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kategorisë “Profesor”, “Lektor” dhe “Asistent lektor” me kohë të plotë dhe të pjesshme. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se personeli akademik efektiv dhe personeli akademik me kontratë i angazhuar në realizimin e programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Drejtësi”, në 5 vite akademike është:									
	Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAK

kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Prof.Dr.	-	-	-	-	-	1	1	1	1	1
Prof. Asoc.	-	1	1	1	3	1	2	4	1	2
Dr./PhD	4	2	7	4	7	4	7	4	11	6
Msc.	1	-	2	3	3	2	4	3	4	3
ME	-	1	1	1	1	1	1	-	-	1
SPA	-	-	-	-	-	-	-	1	-	1
Totali	5	4	11	9	14	9	15	13	17	14

Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc në Drejtësi, janë angazhuar personel akademik me Msc.

GVJ rekomandon që në këtë program studimi, stafi mësimdhënës të ketë të paktën gradën DR, në përmbushje të kërkesave ligjore në fuqi.

Gjithashtu rezulton që shpërndarja e ngarkesës mësimore të lëndëve nuk është gjithmonë në përputhje me kualifikimin akademik të pedagogëve. Psh: Prof. As.Dr. L. H. rezulton me ngarkesë mësimore në të tre fushat e së drejtës, publike, civile dhe penale pavarësisht se profili i tij akademik është më i thelluar në të drejtën civile. Mendojmë që ngarkesa mësimore e lartë dhe në disa disiplina të ndryshme njëkohësisht ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies për këtë arsye rekomandojmë rishikimin e ngarkesave mësimore si në uljen e normës mësimore ashtu dhe përshtatjen e unifikuar të disiplinave me të cilat ngarkohet një mësimdhënës.

Evidenca 2.53 tabelat 6

Evidenca 2.43 _ CV e stafit akademik të programit të studimit

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, (Tabela Permbledhese 12) për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit Msc (PI) në Drejtësi, janë angazhuar staf akademik në tre vite akademike si më poshtë:

	1. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 23 pedagogë nga të cilët 14 PAE dhe 9 PAK (58.56 % / 41.44 %); 2. Për vitin akademik 2023- 2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 28 pedagogë nga të cilët 15 PAE dhe 13 PAK (72.1% / 27.79 %); 3. Për vitin akademik 2024 - 2025 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 31 pedagogë nga të cilët 17 PAE dhe 14 PAK (69.4% / 30.6 %): Në përputhje me VKM nr. 418, datë 10.05.2017, rezulton se në vitin akademik 2024-2025, thuajse ka mbuluar 70% të ngarkesës mësimore, siç parashikohet nga kuadri ligjor përkatës. <i>Megjithatë GVJ konstaton se ngarkesa mësimore e PAE në këtë program studimi varion nga 290-440 orë mësimore në auditor çka duke shtuar dhe ngarkesën administrative të tyre në mendimin tonë (referuar dhe parashikimeve ligjore në fuqi për ngarkesën mësimore) ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të pedagogut.</i> <i>Evidenca_Tabela Përmbledhëse</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga dokumentacioni i paraqitur nga AU, GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi i përket kategorisë “Profesor”, “Lektor” dhe “Asistent Lektor.” Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” kontratat individuale të lidhura me institucionin të kategorisë “Profesorë” dhe “Lektor” janë kontrata pa afat. Ndërsa kontrata e lidhur me stafin akademik të kategorisë “Asistent Lektor” janë kontrata me afat kryesisht 1 vjeçar.

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se procedura e rekrutimit e stafit akademik është e përcaktuar në Statutin e AU dhe Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerzore. Në bazë të akteve të mësipërme dhe konsultimit me procedurat faktike të rekrutimit rezulton se procesi zhvillohet me dosje aplikimi, interviste me gojë dhe përmbyllet me përzgjedhjen përfundimtare nga një komision <i>ad hoc</i>, i cili ka në përbërje Zv rektorin për procesin mësimor, dekanin, drejtuesin e departamentit, një anëtarë të stafit akademik dhe një përfaqësues të zyrës së burimeve njerzore. GVJ konstaton se kontratat e punës për personelin akademik janë hartuar në përputhje me Kodin e Punës dhe legjislacionin specifik për arsimin e lartë, duke garantuar transparencë në marrëdhënien e punës. <i>Evidenca nr.1.01 Statuti Albania University</i> <i>Evidenca nr. 1.28 Rregullore e Zyres se Burimeve Njerzore</i> <i>Evidenca nr. 2.41 Procedura Rekrutimi i Stafit Akademik</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstaton pas vizitës në institucion se njësia përgjegjëse për programin e studimit disponon dy laboratorë funksional, Laboratorin e Informatikës dhe Klinikën Ligjore. Laboratori IT është në shërbim të programit të studimit në bazë të nevojave specifike për të ndërsa, Klinika Ligjore funksionon si njësi ndërdisiplinore duke përmbyllur kërkesat për mjedise të dedikuara për mësim. Institucioni garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike të IT-së dhe Klinikës Ligjore. <i>Evidenca nr. 2.67_ Të dhëna të plota për platformat online/struktura e teknologjisë së informacionit.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të	GVJ nga vizita në terren ka konstatuar se Zyra e Burimeve Njerzore e AU disponon një bazë të dhënash për cdo anëtarë të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi të tilla si: dosje personale të aplikimit për punësim, diplomat dhe certifikatat për kualifikimet e tjera akademike, kontratat e punës, aneks kontratat, Cv etj. Gjithashtu çdo departament mban evidencë të realizimit të ngarkesës mësimore për secilin

personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	semestër siç rezultoi nga shqyrtimi i dosjeve gjatë vizitës në institucion. <i>Evidenca 2.42 _Format i dosjes personale</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni dëshmon një listë të konsiderueshme të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me institucione simotra, institucione shtetërore dhe organizata të ndryshme. Në zbatim të Rregullores së Praktikës Profesionale të AU rezulton se në fillim të vitit akademik Përgjegjësi i Departamentit cakton pedagogë mbikqyrës për ndjekjen dhe zbatimin e praktikës mësimore. Për të munduruar realizimin e praktikave profesionale në këtë program studimi janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit me disa institucione publike, IAL dhe zyra avokatie. Bazuar në këto marrëveshje studentëve u mundësohet logjistika dhe mbështetja e nevojshme në zhvillimin e praktikave dhe ofrimin e eksperiencës në fusha të caktuara të ligjit. <i>Evidenca nr. 2.18 Rregullore e praktikës mësimore.</i> <i>Evidenca 2.52 Marrëveshje në funksion të programit</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Praktika mësimore në AU ndiqet nga pedagogu i caktuar për ndjekjen e praktikës i cili në fund të saj jep një vlerësim më shkrim rreth punës dhe arritjeve të studentit në praktikë duke plotësuar “Formularin e vlerësimit të studentit praktikant.” Në përfundim të praktikës student vlerësohet nga pedagogu mentor si dhe komisioni i ngritur pranë departamentit. <i>Evidenca nr. 2.17 _Formular i praktikës mësimore</i> <i>Evidenca 2.29.1 _Propozim/vendim miratimi, Komisionet e praktikave dhe diplomave</i>
Konkluzione	<i>Në përputhje me VKM nr. 418, datë 10.05.2017, rezulton se në vitin akademik 2024-2025, personeli akademik efektiv (PAE)</i>

	thuaje ka mbuluar 70% të ngarkesës mësimore (në vlerën 69.4%), siç parashikohet nga kuadri ligjor përkatës. Gjithashtu GVJ konstaton se ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv në këtë program studimi varion nga 290 orë në 440 orë, ngarkesë e cila e kalon disa herë ngarkesat mësimore referuese. Mendojmë që ngarkesa mësimore e lartë dhe në disa disiplina të ndryshme njëkohësishtë ndikon drejtëpërdrejtë në cilësinë e mësimëdhënies për këtë arsye rekomandojmë rishikimin e ngarkesave mësimore si në uljen e normës mësimore ashtu dhe përshtatjen e unifikuar të disiplinave me të cilat ngarkohet një mësimdhënës. Përsa i përket kualifikimit të stafit konstatohet se personeli akademik që angzhohet në këtë program studimi nuk plotëson kualifikimin akademik të parashikuar në kuadrin ligjor në fuqi pasi konstatohet se në vitin akademik 2024-2025, 27.7% e personelit akademik janë MSC, megjithatë disa prej janë në procesë doktorature. Mjediset mësimore janë të përshtatshme dhe përfshijnë laboratorët funksionalë me staf ndihmës të dedikuar. Fakulteti ka zhvilluar marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale dhe ndjek me seriozitet procesin e mbikqyrjes akademike të studentëve në realizimin e diplomës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të	Departamenti i Shkencave Juridike e zhvillon aktivitetin e tij akademik në godinën qendrore Bulevardi “Zogu I” Tiranë. Në funksion të programit të studimit janë në dispozicion ambjente të mjaftueshme didaktike si: ➤ 9 salla Leksioni

studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	➤ 10 salla seminari ➤ 1 laborator IT ➤ 1 sallë ku zhvillohen gjyqe imituese. Institucioni disponon gjithashtu dhe një sërë mjedisesh mbështetëse si sallë kompjuterash, një sallë biblioteke, sallë konferencash, etj. <i>Evidenca nr. 1.34 Infrastruktura mësimore e AU</i> <i>Evidenca nr. 2.66 Të dhëna tabelore mjediset e fakultetit/njësive bazë (tabela 16)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në terren GJV konstatoj se të gjitha mjediset ku ushtrohej aktiviteti mësimor ishin të pajisura me pajisje informatike të mjaftueshme për të grantuar procesin mësimdhënës, si kompjutera, projektor, mikrofon, etj. Në takim me studentët u evidentua mundësia e përdorimit të sallave të laboratorëve dhe gjatë procesit të realizimit të detyrave të kursit dhe punimit të tezës së diplomës. <i>Evidenca nr. 1.34 Infrastruktura mësimore e AU</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në dispozicion të programit të studimit funksionon laborator i informatikës i cili është i pajisur me kompjutera të lidhura në rrjet. Gjithashtu në funksion të programit të studimit është një sallë e akomoduar për Klinikën Ligjore në të cilën zhvillohen gjyqet imituese nga studentët dhe aktivitetet e ngjashme të aftësimin praktik. <i>Evidenca nr. 1.34 Infrastruktura mësimore e AU</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të	Në dispozicion të programit të studimit funksionon laborator i informatikës i cili është i pajisur me kompjutera të lidhura në rrjet, gjithashtu dhe një sallë biblioteke të pajisur me mjete

teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	informatike si kompjuter dhe printer, duke lehtësuar aksesin e studentëve në informacion dhe punë kërkimore. <i>Evidenca nr. 1.34 Infrastruktura mësimore e AU</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	GVJ konstatoi se infrastruktura e institucionit siguron një mjedis të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për realizimin e programit të studimit. Institucioni rezulton se ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private për realizimin e praktikës mësimore së programit të studimit. Bashkëpunimet me institucione dhe subjekte të ndryshme garantojnë realizimin efektiv të veprimtarive praktike për studentët. <i>Evidenca nr. 2.52 Marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se Institucioni disponon një infrastrukturë të nevojshme dhe të përshtatshme sipas secilit standard për realizimin me sukses të programit të studimit. <i>AU plotëson kriteret infrastrukturore dhe teknologjike duke ofruar mjedise mësimore të përshtatshme, akses në internet në të gjitha hapsirat dhe rreth 20 kompjutera të shpërndarë në laboratorë dhe bibliotekë si dhe shërbime biblioteke online përmes platformës COBBIS që mbështet procesin mësimor, kërkimor dhe profesional të stafit akademik dhe studentëve të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në përgjithësi literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar është e përputhshme me lëndët/ modulet dhe planprogramin e programit të studimit. Literatura bazë dhe ndihmëse është e përfshirë në syllabuset përkatëse të lëndëve. Nga shqyrtimi i programeve mësimore të lëndëve/moduleve konkludohet se elementi i literaturës që i referohet syllabusve të ndryshme është literature kryesisht bashkohore. Megjithatë GVJ konstaton se në disa lëndë literatura e detyrueshme nga 8 deri në 15 tituj në të cilën përfshihet jo vetëm literatura por dhe Kode/Ligje apo Praktika gjyqësore të ndryshme. <i>GVJ rekomandon që literatura e detyrueshme të kufizohet në maksimumi 2-3 tituj të cilët do të shërbejnë si literaturë bazë gjatë të gjithë zhvillimit të lëndës si dhe prej këtij zëri të vecohen Kodet/ligjet dhe praktika gjyqësore. GVJ sjell si shëmbuj të konstatimit të mësipërm raste si:</i> - Syllabusi i lëndës “E drejtë publike” – 15 tituj literaturë të detyrueshme; - Syllabusi i lëndës “Historia e Shtetit” – 11 tituj literaturë e detyrueshme; - Syllabusi i lëndës “E drejtë Administrative” – 8 tituj literaturë e detyrueshme ndër të cilat 1 Kod dhe 2 Vendime Unifikuese; - Syllabusi i lëndës “E drejtë Penale e posaçme” - 8 tituj literaturë e detyrueshme ndër të cilat 3 Kode dhe 2 praktika gjyqësore; - Syllabusi i lëndës “E drejtë ndërkombëtare Private” - 13 tituj. Etj; <i>Evidenca 3.08 Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë	Gjatë takimit me stafin akademik GVJ konstatoi se titullarët e lëndëve, në bashkëpunim me departamentin përkatës ndërmarrin rishikime të rregullta të syllabusve të lëndëve të këtij programi

përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	studimi me qëllim përditësimin e nevojave të tregut të punës. Titullarët e lëndëve rishikojnë dhe përditësojnë përmbajtjen e lëndëve, përfshirë objektivat, rezultatet e të nxënit dhe përditësimin e literaturës së detyrueshme dhe të rekomanduar. Syllabuset e rishikuara miratohen cdo vit nga përgjegjësi i departamentit. Ky proces synon të garantojë që studentët të kenë akses në burimet bashkëkohore në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e shkencave juridike. <i>Megjithatë GYJ rekomandon të kushtohet vëmendje literaturës të detyrueshme në syllabuse sipas rekomandimeve në Kriterin 1 të këtij standardi.</i> <i>Evidenca 3.08 Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e institucionit është një ambient i përshtatshëm për studime dhe i aksesueshëm në fasha orare të përshtatshme për studentët. <i>Evidenca nr. 2.67 Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Në funksion të aktivitetit kërkimor shkencor të stafit akademik dhe studentëve është ngritur dhe funksionon biblioteka si pjesë e infrastrukturës së departamentit përgjegjës për këtë program studimi. Katalogimi rezultoi i saktë dhe i qartë për tu aplikuar nga të interesuarit. Nga vizita në bibliotekë rezultoi se një pjesë e konsiderueshme e literaturës bazë gjendej në minimumin 5 kopje fizike gjithashtu dhe një pjesë e literaturës së rekomanduar të listuar në syllabuset përkatëse. Biblioteka ka një hapsirë dhe organizim të përshtatshëm që mundëson përdorimin në kushte optimale. <i>Evidenca nr. 2.67 Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në	Biblioteka online është e aksesueshme për cdo student të interesuar, duke qënë e pajisur edhe me kapacitetet të përshtatshme infrastrukture si poste leximi, wifi, printer etj. Në sistemin e bibliotekës rezultojnë të ngarkuar edhe literaturë elektronike nga ana e institucionit si dhe aksesimi në bibliotekën

bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	online COBBIS. Si dhe rezulton abonimi në disa revista online si ERIC-Education Resource Information Center, Cambridge Journals, etj. <i>Evidenca nr. 2.67 Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka disponon infrastrukturë të konsoliduar dhe bashkëkohore kompjuterike për të gjithë studentët e këtij programi studimi. <i>Evidenca nr. 2.67 Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Rezulton se Biblioteka është në dispozicion të studentëve gjatë të gjithë orarit zyrtar të punës nga ora 08:00 deri në orën 20:00 dhe ditën e shtunë nga ora 08:00- 12:00. Orare këto të aksesueshme lehtësisht nga stafi akademik dhe studentët.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për	Nga takimi me stafin e bibliotekës u konstatua raportimet periodike që stafi bën në departamentin përkatës në lidhje me literaturën, frekuentmin e sallave të leximit etj. Gjithashtu evidentohen kërkesat për tituj të rinj, sygjerimet për pasurimin e fondit dhe efikasitetit të përdorimit të katalogut online. Megjithatë <i>GVJ nuk e pati të mundur të evidentoj numrin e saktë të titujve shtuar në vitet e fundit në funksion të këtij programi studimi.</i>


pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se në disa lëndë literature e detyrueshme nga 8 deri në 15 tituj në të cilën përfshihet jo vetëm literaturë teorike por dhe Kode/Ligje apo Praktika gjyqësore të ndryshme.</i> <i>GVJ rekomandon që literature e detyrueshme të kufizohet në maksimumi 2-3 tituj të cilët do të shërbejnë si literaturë bazë gjatë të gjithë zhvillimit të lëndës si dhe prej këtij zëri të vecohen Kodet/ligjet dhe praktika gjyqësore.</i> <i>GVJ konstaton se biblioteka fizike dhe onlie vihet në dispozicion të të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë, pa pagesë dhe në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor për këtë program studimi.</i> <i>Salla e bibliotekës ka internet dhe është e pajisur me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën dhe materialet online.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në	Materiali i paraqitur nga ana e institucionit ofron një pasqyrë të përgjithshme dhe të qartë për studentët përgjatë studimeve në programin e studimit. AU disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional i cili mundëson administrimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të të dhënave që lidhen me studentët dhe ecurinë e tyre akademike përgjatë gjithë ciklit të studimeve që nga regjistrimi deri në përfundim të programit. AU përdor në funksion të këtij kriteri platformën PITAGORA.

diplomim në programin e studimit.	<i>Evidenca nr. 2.67 Të dhëna të plota për platformat online/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni mirëmban sistem të brendshëm informativ lidhur me personelin e përfshirë në realizimin e programit të studimit.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Ekziston mundësia e lehtë e aksesit në informacione e materiale lidhur me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit. Njësia përgjegjëse siguron shpërndarje të plotë të çdo aktiviteti që lidhet me programin e studimit, përmes faqes zyrtare të WEB-it, komunikimit elektronik drejt stafit dhe studentëve si dhe përmes rrjeteve sociale që administrohen nga institucioni.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Rezulton se studentët dhe stafi akademik kanë akses me kredenciale personale në materiale mësimore, orarin mësimor, kurrikulën e programit të studimit, njoftime institucionale, rezultatet e provimeve, etj. Sistemi i menaxhimit sigurohet nëpërmjet infrastrukturës së Rrjetit dhe Hardëeare, Microsoft 365, One drive, sharepoint, pitagora, etj. <i>Evidenca nr. 1.32 Manual i përdorimit të strukturës së Teknologjisë Informacionit</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Disponohet me sistem efikas në procesin e monitorimit për aktivitetet akademike për personelin dhe studentët. Njësia përgjegjëse përdor platforma elektronike/online për komunikim interaktiv dhe publikim materialesh për studentët, duke mundësuar monitorimin në kohë reale të aktivitetëve. Gjithashtu sistemi elektronik i menaxhimit të informacionit përmes rrugëve elektronike, faqes zyrtare, rrjeteve sociale dhe Zyrës së Informacionit siguron monitorim të vazhdueshëm të aktivitetit akademik dhe administrative duke lejuar evidentimin dhe trajtimin në kohë reale të çdo problematike të raportuar.



Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Rezulton se për publikimin e informacioneve mbi programin e studimit, personelin akademik, organizimin institucional dhe aktivitetet e ndryshme AU përditëson në kohë reale faqen zyrtare të internetit dhe rrjetet sociale të dedikuara të AU.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni disponon sistem për monitorimin e mbarëvajtjes së punës akademike të personelit dhe studentëve.</i> <i>Komunikimi me studentët dhe stafin akademik realizohet në mënyrë efektive përmes platformave digitale dhe rrjeteve sociale të institucionit duke siguruar akses dhe monitorim në kohë reale.</i> <i>Organizimi dhe publikimi i eventeve dhe aktiviteteve garanton transparencë dhe informim të mirëfillt. Këto elemente përforcojnë cilësinë dhe efikasitetin e procesit arsimor dhe kërkimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Rezulton se institucioni harton pasqyra dhe raporte financiare vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshijnë dhe plan buxhetin e institucionit. Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se AU disponon një fond rezervë emergjence për mosçenimin e mbarëvajtjes së studimit për një cikël të plotë studimi. <i>Evidenca nr. 2.45Buxheti 2023-2025 (viti fiskal 2023)</i> <i>Evidenca nr. 2.68Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)</i>

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni harton dhe mirëmban plane të besueshme financiare për të gjitha strukturat organizative. Buxheti përfshin kuotat e detajuara për vitin kalendarik, investimet e brëndshme për pajisje elektronike dhe mobilim auditoresh, përmirësim softuerësh dhe bazash të dhënash. Gjithashtu përfshihen fondet për pagat e stafit, shpenzimet operative dhe infrastrukturore si dhe mbështetje për aktivitetet kërkimore shkencore. <i>Evidenca nr. 2.45 Buxheti 2023-2025 (viti fiskal 2023)</i> <i>Evidenca nr. 2.68 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Rezulton se AU realizon auditim financiar të përvitshëm në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Auditimi kryhet nga subjekte të licensuara dhe të pavarura duke garantuar objektivitetin dhe transparencën e procesit. Auditimi vlerëson menxhimin financiar, sistemin e pagave, burimeve njerëzore, menaxhimin buxhetor si dhe tarifimin e programit të studimit. Raportet e auditimit sigurojnë saktësinë e regjistrave financiare dhe respektimin e legjislacionit në fuqi. <i>Evidenca nr. 1.35 Raport auditimi dhe Pasqyra financiare</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Raportet financiare të institucionit janë të qarta dhe të besueshme.

Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni menaxhon burimet e tij organizative në funksion të qëndrueshmërisë financiare për mbarrëvajtjen e programit të studimit. Menaxhimi nënkupton edhe evaluimin e menaxhimit financiar në rast të përmirësimit të situatës.			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare lidhur me programin e studimit. AU i nënshtrohet auditimit të brendshëm periodik në përputhje me standardet ligjore në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe	Institucioni ka të përcaktuara politika dhe procedura të qarta për gjithë ciklin akademik të studentit, nga pranimi deri në

procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	diplomim, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 dhe VKM nr. 879, dt. 18.12.2019. Këto politika janë të integruara në Statutin e universitetit, Rregulloren e Përgjithshme dhe Rregulloren e Programit të Studimit. Zyra e Regjistrimeve dhe Transferimeve siguron zbatimin korrekt të procedurave, duke ndjekur studentët në çdo fazë të ciklit akademik. <i>Evidenca 1.01 Statuti</i> <i>Evidenca 1.02 Rregullore e përgjithshme e AU</i> <i>Evidenca 1.21 Rregullore e regjistrimeve dhe e transferimeve</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni siguron që çdo proces, që nga momenti i pranimi në program e deri te diplomimi, të bazohet në parimin e barazisë së mundësive dhe të mosdiskriminimit. Njesia kryesore gjatë çdo faze të ciklit të studimeve monitoron proceset duke garantuar transparencë për të gjithë kandidatët dhe studentët. <i>Evidenca 1.02 Rregullore e përgjithshme e institucionit</i> <i>Evidenca 2.07 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidenca 2.05 Procedurat e pranimi dhe transferimeve</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kriteret e pranimi dhe përzgjedhjes përcaktohen çdo fillim viti akademik nga Senati Akademik, në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MASR). Ato publikohen në mënyrë transparente në portalin zyrtar të maturës shtetërore dhe në faqen zyrtare të universitetit, duke garantuar informim të gjerë dhe të barabartë për të gjithë kandidatët. Procesi i pranimi bazohet në parimin e meritës, duke marrë në konsideratë mesataren e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe kriteret specifike të programit të studimit. <i>Evidenca 2.46 Kriteret e vecanta kuota</i> <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit të studimit</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimi-2/
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të	Kriteret dhe procedurat që rregullojnë pranimin, përzgjedhjen, transferimin dhe diplomimin e studentëve janë të përcaktuara qartë në aktet e universitetit dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit. Kjo siguron që çdo kandidat apo student të ketë

studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	akses në informacion. Institucioni garanton transparencë dhe objektivitet në zbatimin e procedurave, duke respektuar standardet ligjore dhe rregullat e brendshme. <i>Evidenca 1.21 Rregullore e mbi procedurat e pranimi dhe transferimit</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimi/
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	AU informon publikun dhe kandidatët për kriteret dhe kërkesat e përgjithshme e të veçanta për çdo program studimi përmes faqes zyrtare dhe Ditëve të Informimit organizuar nga MAS. Informacioni është gjithashtu i përfshirë në rregulloren mësimore të programit të studimit. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit të studimit</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimi/ https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/regjistrime-ne-au-sq/
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Institucioni ka politika të veçanta për pranimin e kandidatëve nga shtresat e marginalizuara, me aftësi ndryshe dhe komunitete minoritare. Vendimi i Senatit Akademik përcakton kuota të dedikuara dhe zbatimi është i dokumentuar për çdo vit akademik. <i>Evidenca 2.46.1 Kriteret e vecanta kuota</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Për kandidatët nga shtetet e tjera, institucioni përcakton dhe publikon kriteret e veçanta të pranimi çdo vit, të miratuara nga Senati Akademik dhe të përcjella në MASR. <i>Evidenca 2.46.1 Kriteret e vecanta kuota</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për	“Albanian University” ka politika bursash dhe ndihme për studentët nga shtresat në nevojë dhe për promovimin e ekselencës. Vendimet për bursat miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, duke përfshirë kategori si jetimë, studentë me aftësi ndryshe, fëmijë policësh të rënë në detyrë dhe studentë nga komunitete minoritare.



zhvillimin ekonomik të vendit.	Evidenca 2.46.1 Kriteret e vecanta kuota https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/			
Konkluzione	GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara konstaton se institucioni ka të dokumentuara politika të qarta, transparente dhe gjithëpërfshirëse që mbulojnë ciklin e plotë të jetës akademike të studentëve. Të gjitha procedurat janë të bazuara në kuadrin ligjor dhe të aksesueshme publikisht nga të gjithë studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni siguron informimin e plotë të studentëve për kriteret dhe procedurat e përparimit akademik që në momentin e regjistrimit. Rregullorja e programit të studimit dhe udhëzuesi didaktik i programit përcaktojnë qartë mënyrën e kalimit nga një vit në tjetrin, kufijtë minimalë të si dhe detyrimet akademike për studentët. <i>Evidenca 1.16 Rregullore e Sekretarisë Mesimore.pdf</i> <i>Evidenca 2.40 Udhëzues Didaktik i Programit</i> <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Zyra e Regjistrimeve dhe Transferimeve në bashkëpunim me Departamentin garanton procedura të qarta për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve. Njësia kryesore ngre një Komision ad hoc për njohjen e krediteve dhe transferimin e studentëve. <i>Evidenca 2.08 Rregullore e Departamentit</i>

	<i>Evidenca 1.21 Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët njihen që në fillim të vitit akademik me kriteret, format dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive, nëpërmjet ditëve orientuese dhe prezantimit të syllabusit të secilës lëndë. Syllabusi përmban të gjitha elementet e nevojshme për orientimin e studentëve, përfshirë: - mënyrën e zhvillimit të provimeve ndërmjetëse dhe përfundimtare; - format e testimit (me shkrim, me gojë, ese, projekte apo prezantime), si dhe - peshën përkatëse të secilës komponentë në vlerësimin final; <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 1.25 Manuali i studentëve</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Departamenti informon studentët për kriteret dhe procedurat e përgatitjes e mbrojtjes së diplomës, të përcaktuara qartë në Rregulloren e Programit të Studimit dhe në Udhëzuesin për Diplomën. Studentëve u vihen në dispozicion rregullat dhe formati standard i punimit. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.29 Udhëzues përgatitje teme diplome</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni organizon javën e orientimit për studentët e rinj dhe publikime periodike përmes faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale. Përveç kësaj, Zyrat e Koordinimit dhe Këshilli Studentor ofrojnë mbështetje të vazhdueshme dhe informim mbi procedurat akademike dhe jetën studentore. <i>Evidenca 1.23 Rregullore e ZKMS</i> <i>Evidenca 1.24 Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>Evidenca 2.48 Të dhënat nga ZKSHS</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Institucioni ka një sistem të qartë, transparent dhe funksional për informimin e studentëve në çdo fazë të ciklit akademik. Evidencat e analizuara tregojnë se të gjitha procedurat janë publike e të aksesueshme.</i>

	<i>Praktikat e komunikimit me studentët (udhëzues, broshura, ditë orientimi, njoftime online) tregojnë për angazhimin në informimin dhe mbështetjen e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni siguron një proces të vazhdueshëm informimi për strukturën dhe organizimin e programit, nëpërmjet Ditëve të Informimit për masantët, broshurave, materialeve audiovizive dhe prezantimeve nga Dekani, përgjegjësi i Departamentit dhe stafi akademik. Studentët marrin udhëzime të vazhdueshme nga koordinatori i programit dhe zyra e mbështetjes studentore. Informacionet janë gjithashtu të aksesueshme në faqen zyrtare të universitetit në seksionin e studentëve. <i>Evidenca 1.25 Manuali i studentëve</i> <i>Evidenca 2.48 Të dhënat nga ZKSHS</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentëve u vihet në dispozicion një Udhëzues Didaktik që përfshin planin mësimor, përshkrimet e lëndëve dhe informacionin për vlerësimin. Çdo pedagog prezanton në fillim të semestrit syllabusin e lëndës, objektivat, format e vlerësimit dhe detyrimet e studentëve. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 2.40 Udhëzues didaktik i programit</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si	Nga takimet me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit dhe Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët u konstatua se këto zyra ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për orientimin

dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	profesional të studentëve. Aktivitetet përfshijnë Ditët e Karrierës, simulime intervistash pune, takime me punëdhënës dhe mentorim individual. Përmes marrëveshjeve me institucione dhe biznese, studentët informohen për mundësi konkrete punësimi dhe praktika profesionale. <i>Evidenca 1.18 Rregullore e ZKKA</i> <i>Evidenca 1.20 Praktikë -Aktivitet Alumni</i> <i>Evidenca 2.48 Të dhënat nga ZKSHS</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Departamenti dhe sekretaria mësimore informojnë studentët për procesin akademik, oraret, kalendarin dhe infrastrukturën përmes sistemit elektronik Pitagora, sekretarisë online dhe platformave si Microsoft Teams. Studentët kanë akses në kohë reale në njoftimet mbi oraret, provimet, si dhe aktivitetet akademike dhe sociale. <i>Evidenca 3.02 Kalendar Akademik</i> <i>Evidenca 3.06 Orari Mësimor</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni ka siguruar mjete efektive për komunikim në distancë përmes faqes zyrtare të universitetit dhe platformës Microsoft Teams, e cila lejon informim në kohë reale mbi mësimet, oraret dhe aktivitetet akademike. Studentët kanë akses të plotë në informacionin institucional. www.albanianuniversity.edu.al			
Konkluzione	<i>Aktivitetet orientuese dhe mbështetëse janë të dokumentuara e transparente ndërsa faqja zyrtare dhe platformat online sigurojnë barazi në informacione e aksesueshmëri.</i> <i>GVJ konstaton se ka një sistem të qartë informimi dhe komunikimi me studentët për strukturën, përmbajtjen dhe rezultatet e pritshme të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																								
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria Mësimore, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit, përgatit çdo vit statistika të sakta për regjistrimet, diplomimet, largimet dhe transferimet e studentëve në programin “Master i Shkencave në Drejtësi”. <i>Evidenca 2.71 Cilësia në hyrje dh në dalje e studentëve</i> <i>Evidenca 2.73 Numri i studentëve të diplomuar</i>																								
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni mban statistika për çdo vit akademik dhe ndjek procesin e regjistrimeve dhe diplomimeve. Sekretaria Mësimore administron regjistrat hard copy dhe elektronikë për çdo student. Për çdo regjistrim hapet dosje personale me të dhëna për ecurinë akademike, notat, bursat dhe rezultatet e provimeve. Të dhënat janë të verifikueshme dhe të arkivuara sipas rregullores përkatëse. Referuar të dhënave të marra gjatë vizitës në institucion, numri i studentëve për këtë program studimi rezulton të jetë si më poshtë: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Nr. i të regjistruarve</th><th>Nr. i të çregjistruarve</th><th>Nr. aktual</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>20</td><td>3</td><td>17</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>16</td><td>2</td><td>14</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>23</td><td>5</td><td>18</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>14</td><td>-</td><td>14</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>25</td><td>-</td><td>25</td></tr></table> <i>Evidenca 1.16 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 2.71 Cilësia në hyrje dh në dalje e studentëve</i> <i>Evidenca 2.47 Shembull Dosje Transferimi</i>	Viti akademik	Nr. i të regjistruarve	Nr. i të çregjistruarve	Nr. aktual	2020-2021	20	3	17	2021-2022	16	2	14	2022-2023	23	5	18	2023-2024	14	-	14	2024-2025	25	-	25
Viti akademik	Nr. i të regjistruarve	Nr. i të çregjistruarve	Nr. aktual																						
2020-2021	20	3	17																						
2021-2022	16	2	14																						
2022-2023	23	5	18																						
2023-2024	14	-	14																						
2024-2025	25	-	25																						
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve	Të dhënat statistikore menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta. Të dhënat e																								

duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	studentëve administrohen në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Aksesin e kanë vetëm personat e autorizuar të Sekretarisë Mësimore. <i>Evidenca 1.16 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 2.71 Cilësia në hyrje dh në dalje e studentëve</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni mbështet me akte kontrollin periodik të njësive për menaxhimin e të dhënave. Kontrolli periodik i regjistrave dhe i saktësisë së informacionit realizohet nga Sekretaria Mësimore dhe raportet vjetore janë të dokumentuara. Portali studentor “Pitagora” lehtëson verifikimin e rezultateve dhe aksesin në të dhëna. <i>Evidenca 1.16 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 2.71 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia bazë harton raporte analitike periodike mbi profilin e studentëve, përfshirë të dhënat demografike, akademike dhe ecurinë gjatë studimeve. Këto raporte shërbejnë si instrument monitorimi dhe vlerësimi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. <i>Evidenca 2.09 Raport vjetor i Departamentit</i> <i>Evidenca 2.71 Cilësia në hyrje dh në dalje e studentëve</i>
Konkluzione	<i>GVJ në lidhje me gjetjet e evidentuara dhe nga vizita në institucion konstaton se AU administron me kujdes të dhënat e studentëve dhe ka mekanizma funksionalë për ruajtjen dhe sigurinë e tyre. AU garanton sigurimin e cilësisë përmes hartimit të raporteve analitike periodike mbi profilin dhe ecurinë akademike të studentëve të cilat shërbejnë si bazë për monitorim të vazhdueshëm dhe përmirësim të programeve të studimit.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Institucioni parashikon dhe garanton pjesëmarrjen aktive të studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, si një element thelbësor i kulturës institucionale demokratike dhe i përfshirjes në proceset e qeverisjes universitare. Në përputhje me Statutin e institucionit, studentët kanë përfaqësues të zgjedhur në Senatin Akademik, si dhe në komisione të tjera, përfshirë Komisionin e Etikës, Komisionin e Kurrikulave dhe Komisionin e Cilësisë. Përfaqësimi i studentëve i cili u konstatua edhe nga intervistat me studentët në institucion siguron që zëri i tyre të merret parasysh në proceset vendimmarrëse, duke ndihmuar në ndërtimin e një mjedisi universitar gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues. <i>Evidenca 1.01 Statuti i institucionit</i> <i>Evidenca 2.49 Vendimet e emerimit te organeve AU</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në jetën institucionale studentët nuk janë vetëm pjesëmarrës formalë, por kontribuojnë aktivisht në proceset e vendimmarrjes, konsultimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike. Ata përfshihen në grupet e punës për rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, duke dhënë sugjerime mbi përmbajtjen, metodologjinë mësimore dhe lidhjen e kurrikulave me tregun e punës. <i>Evidenca 2.49 Vendimet e emerimit te organeve AU</i> <i>Evidenca 2.50 Raporti i Vlerësimit të Studenteve</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e	Përfshirja e studentëve realizohet përmes disa mekanizmave konkretë, si:

studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	- pyetësorët periodikë ku studentët japin mendime mbi përmbajtjen dhe organizimin e lëndëve, metodat e mësimdhënies dhe procesin e vlerësimit; - focus-grupet e studentëve, të organizuara nga departamenti për të mbledhur komente të detajuara mbi përmirësimet e nevojshme në kurrikula; - përfaqësimi në Komisionin e Kurrikulave, ku studentët marrin pjesë drejtpërdrejt në diskutime dhe në procesin e miratimit të ndryshimeve të propozuara; <i>Evidenca 1.06 Rregullore e Zyres së Zhvillimit të Kurrikulave.pdf</i> <i>Evidenca 1.33 Pyetësori i studentëve</i> <i>Evidenca 2.50 Raport i vlerësimit të studentëve</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u garantohej e drejta për të shprehur mendimin mbi paanshmërinë e vlerësimit dhe për të kërkuar ankim. Rregullorja e Fakultetit dhe ajo e Programit parashikojnë të drejtën për ankim dhe shqyrtimin e tij nga komisione të posaçme të ngritura nga autoritetet drejtuese përgjegjëse për këtë program studimi. <i>Evidenca 3.01 Rregullore e programit të studimit, neni 45 dhe 46</i> <i>Evidenca 2.07 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore neni 24 dhe 26</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se AU siguron pjesëmarrje të studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësimit të tyre në organe kolegiale institucionale dhe në vlerësimin e cilësisë së programeve.</i> <i>Mekanizmat për pjesëmarrjen e studentëve në proceset vendimmarrëse janë funksionale dhe të dokumentuar, duke garantuar transparencë dhe bashkëpërgjegjësi akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni ka ngritur struktura funksionale që mbulojnë informimin dhe mbështetjen e studentëve në mënyrë të vazhdueshme. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit përbëjnë njësitë qendrore që ofrojnë udhëzime dhe mbështetje për studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve. Përveç tyre, Departamenti dhe Sekretaria Mësimore luajnë rol aktiv në orientimin akademik dhe në informimin mbi proceset mësimore. <i>Evidenca 1.16 Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i> <i>Evidenca 1.18 Ev 1.18 Rregullore e ZKKA</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni ofron orientim dhe këshillim për studentët që nga momenti i regjistrimit, përmes Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, duke vijuar me asistencë gjatë studimeve përmes tutorimit dhe konsultimeve nga pedagogët. Zyra e Karrierës dhe Alumnit siguron vazhdimësinë e këtij shërbimi edhe pas diplomimit <i>Evidenca 1.23 Rregullore e ZKMS</i> <i>Evidenca 1.18 Rregullore e ZKKA</i> <i>Evidenca 2.08 Rregullore e Departamentit</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione	Nga takimet në institucion u konstatua se Zyra e Karrierës dhe Alumnit ofron shërbim të vazhdueshëm për studentët dhe të diplomuarit, përfshirë orientimin për praktikën profesionale, ndihmën në aplikime për punësim, dhe organizimin e aktiviteteve të dedikuara (workshop-e, ditë karriere, prezantime me kompani bashkëpunëtores). Bashkëpunimi me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, si dhe me klubet studentore, siguron zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare që ndihmojnë studentët në zhvillimin e aftësive të buta dhe në ndërtimin e rrjeteve profesionale. <i>Evidenca 2.48 Të dhënat nga ZKSHS</i>

të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<i>Evidenca 1.20 Praktikë -Aktivitet Alumni</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Karrierës dhe Alumnit menaxhon një bazë të dhënash për të diplomuarit dhe ndjek zhvillimin e tyre profesional në tregun e punës. Ajo organizon takime periodike me alumni për shkëmbim eksperiencash dhe për nxitjen e bashkëpunimeve akademike e profesionale. Zyra mban evidenca të përditësuara mbi punësimin e ish-studentëve dhe u ofron atyre referenca për punësim apo studime pasuniversitare. Megjithëse programi “Master i Shkencave në Drejtësi” është i ri dhe nuk ka ende të diplomuar, praktikant ekzistues në universitet dëshmojnë se mekanizmat për ndjekjen e alumnëve janë funksionale, megjithatë <i>GVJ sugjeron forcimin e ndjekjes së studentëve dhe përmirësimi i sistemit të mbledhjes e analizës së të dhënave për alumni, veçanërisht për programet e reja të studimit.</i> <i>Evidenca 1.20 Praktikë -Aktivitet Alumni</i>			
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara konstaton se AU ka njësi ndihmës akademike të mirëorganizuara dhe funksionale për orientimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë karrierës së tyre akademike.</i> <i>GVJ konstaton se për këtë qëllim ka zyra të dedikuara me anëtarë të stafit akademik si dhe procedura të dokumentuara dhe aktivitet të rregullt të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT



Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni ka prodhuar dokumenta të nevojshme për të mbështetur përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në funksion të programit të studimit përdoren metoda innovative dhe interaktive si Microsoft Teams, Pitagora. Nga evidencat e parqitura rezulton se institucioni ka zhvilluar trajnime të ndryshme për përdorimin e instrumenteve informatik në funksion të mësimdhënies. <i>Evidenca 1.31 Trajnime stafi për përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Në bazë të procesit të vlerësimit të punës akademike të personelit akademik dhe ndihmësakademik sigurohet monitorimi efikas nga ana e strukturave drejtuese të institucionit. Strukturat përgjegjëse kanë krijuar mekanizma të qëndrueshëm për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik nërmjet strukturave si Njësisë së Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin të cilët monitorojnë në vazhdimësi plotësimin e standardeve të cilësisë në mësimdhënie nga stafi akademik dhe ai ndihmës akademik, përmes vlerësimeve semestrale të studentëve dhe monitorimeve në auditor. <i>Evidenca 1.33.2 Analizë e pyetësorit për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 2.19 Raport semestral i pedagogut PAE/PAK</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,	Departamenti përgjegjës për programin e studimit siguron mundësi konkrete për studentët për të dhënë opinionet e tyre mbi metodat e mësimdhënies dhe procesit të vlerësimit të dijeve, duke nxitur përfshirjen aktive të tyre nëpërmjet pyetësorve të vlerësimit. Gjithashtu ekzistojnë mekanizma të qartë për ankimin e rezultateve të vlerësimit që garantojnë transparencë dhe mundësi rishikimi sipas parashikimeve të bëra në Statutin

përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	dhe Rregulloren e Përgjithshme të AU. Kjo kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor dhe vlerësues. <i>Evidenca. 1.02 Rregullore e Përgjithshme AU</i> <i>Evidenca 1.33.2 Analizë e pyetësorit për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 1.33.1 Analizë e pyetësorit për mësim online</i> <i>Evidenca 1.33 Pyetësori i studentëve</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, NJSBC përgatit një raport mbi gjetjet dhe rezultate të pyetësorit të studentëve ku identifikon rastet specifike apo problematike dhe ja paraqet këtë raport Departamentit përgjegjës për programin e studimit (DSHJPA). Nga shqyrtimi i evidencave rezulton se vlerësimi personal i bëhet i ditur pedagogëve individualisht përmes emailit. Në pjesën e fundit të raportit të vlerësimit të hartuar nga NJBSC konstatohen rekomandime për përmirësimin e vlerësimit të veprimtarisë akademike dhe mbarvajtjes të procesit mësimor. <i>GVJ rekomandon që NJSBC në bashkëpunim me njësinë kryesore përgjegjëse për programin e studimi të marr masat e domosdoshme për përmbushjen e rekomandimeve të përfituara nga analiza e pyetësorëve.</i> <i>Evidenca 1.05 Raporti Vjetor i Njësisë së Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë 2023-2024</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Procesi i vlerësimit të punës akademike të personelit nga ana e studentëve ndihmon në avancimin e mësimdhënies në program. GVJ konstaton angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se institucioni ka siguruar një proces të mirëfillt monitorimi për punën akademike të personelit nëpërmjet metodës së vlerësimit periodik nga ana e studentëve dhe monitorimeve në auditor. Sipas evidencave të konsultuara për</i>



	<i>këtë raport mekanizmat kryesor të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri si dhe raportet vjetore të realizuara nga NJSBC.</i> <i>Nëprmet mekanizmave të mësipërm institucioni nxit përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe promovimit të praktikave më të mira në vlerësimin e performancës së personelit akademik.</i> <i>GVJ rekomandon që NJSBC në bashkëpunim me njësinë kryesore përgjegjëse për programin e studimit të marrë masat e domosdoshme për përmbushjen e rekomandimeve të përfituara nga analiza e pyetësorëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Statuti i AU dhe aktet e tjera të brendshme të tij parashikojnë mekanizma për sigurimin e cilësisë në institucion. GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në AU janë: Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe NJSBC të cilat rregullojnë veprimtaritë e tyre me akte nënligjore të brendshme. Gjithashtu në nivel institucioni funksionon dhe Komisioni i Vlerësimit Institucional i cili është përgjegjës për ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit të Brendshëm të Cilësisë në AU, veprimtaria e të cilët mbështetet në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. <i>Evidenca 10.6 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave</i> <i>Evidenca 1.07 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC</i> <i>Evidenca 1.08 Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në AU</i>

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ konstaton se në bazë të vlerësimit të punës akademike të personelit akademik dhe ndihmësakademik sigurohet monitorimi efikas nga ana e strukturave drejtuese të institucionit. Strukturat përgjegjëse kanë krijuar mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së stafit akademik dhe ndihmësakademik në përputhje me aktet nënligjore rregullatore të institucionit. Këto mekanizma përfshijnë vlerësime periodike të procesit mësimor të cilat ndihmojnë në identifikimin e nevojave për zhvillim profesional dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies. <i>Evidenca 1.29.1 VBA për caktimin e ekspertit konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave.</i> <i>Evidenca 1.08 Strategjia për Sigurimin e Brëndshëm Cilësisë në AU</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ konstaton se instrumenti kryesor për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimdhënës është pyetësori periodik që zhvillohet me studentët e programit të studimit për stafin akademik dhe ofertën akademike. Të dhënat e pyetësorit analizohen dhe vlerësohen nga NJSBC e cila në fund të cdo viti akademik përpilon një raport vjetor bazuar në këto të dhëna. Raporti vjetor i përcillet për shqyrtim dhe vlerësim Departamentit përgjegjës për programin e studimit. <i>GVJ rekomandon që përveç instrumentit të pyetësorit të studentit për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies të përdoren dhe instrumenta të tjerë vlerësues si monitorimi periodik në auditor apo intervista me kampion mbi metodat e mësimdhënies apo problematika të tjera të hasura gjatë procesit mësimor.</i> <i>Evidenca 1.05 Raporti Vjetor i Njësisë së Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë 2023-2024</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e	Institucioni përdor tregues të matshëm dhe të qartë sipas standardit kombëtar dhe ndërkombëtar referuar gjendjes reale të procesit akademik në program. Departamenti përgjegjës për programin e studimit monitoron cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit përmes treguesve të paracaktuar duke identifikuar praktikën e suksesshme për përmirësim të vazhdueshëm si dhe duke evidentuar rekomandimet përkatëse për përmirësim.

treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	<i>Evidenca 1.03 Strategjia për Zhvillimin Institucional të AU 2023-2024</i> <i>Evidenca 1.08 Strategjia për Sigurimin e Brëndshëm Cilësisë në AU</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ndjek politika të qarta dhe zbaton mekanizma efikas për sigurimin e cilësisë në procesin akademik dhe realizimin e programit të studimit.</i> <i>GVJ konstaton se mekanizmi kryesorë i monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri si dhe raportet vjetore të NJSBC.</i> <i>GVJ rekomandon që përvec instrumentit të pyetësorit të studentit për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies të përdoren dhe instrumenta të tjerë vlerësues si monitorimi periodik në auditor apo intervista me kampion mbi metodat e mësimdhënies apo problematika të tjera të hasura gjatë procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe	GVJ konstaton se janë hartuar raporte vjetore nga NJSBC lidhur me mbikëqyrjen e programit të studimit në bazë të mekanizmave të përdorur për vlerësimin e cilësisë. Këto raporte i janë përcjell autoriteteve drejtuese të AU si dhe Departamentit përgjegjës për programin e studimit. Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit është Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe NJSBC. GVJ konstatoi se AU përdor mekanizma dhe procese specifike për garantimin e mbikëqyrjes dhe programit të studimit si psh: raporte vjetore, pyetësor periodik të studentëve për të vlerësuar

arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	cilësinë e mësimdhënies apo formularët që plotësohen për të deklaruar aktivitetin shkencor që janë zhvilluar gjatë vitit akademik si dhe mbledhjet periodike që zhvillohen nga njësia bazë përgjegjëse ku personeli akademik njihet me vlerësimet e pyetsorit. <i>Evidenca 1.05 Raporti Vjetor i Njesisë së Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë 2023-2024</i> <i>Evidenca 2.09 Raporti Vjetor i FSHSH V/A 2023-2024</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ konstaton se raportet e hartuara flasin për përputhshmërinë e objektivave të programit me kërkesat normative përkatëse kombëtare. Monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të gjetjeve të konstatuara realizohet nga NJSBC-ja nëpërmjet monitorimeve të vazhdeshme nga personat përgjegjës, autoritetet drejtuese si dhe nga diskutimet me stafin akademik si dhe pyetësorët. Raportet vjetore përfshijnë të dhëna mbi zbatimin e planit të veprimit të vitit të kaluar dhe planin për vitin pasardhës. <i>Evidenca 1.05 Raporti Vjetor i Njesisë së Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë 2023-2024</i> <i>Evidenca 2.09 Raporti Vjetor i FSHSH V/A 2023-2024</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e	Metodat e ndjekura për vlerësimin e nivelit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në AU janë të qarta dhe të drejtpërdrejta si: Vlerësimi me notë dhe pikë; hartimi i testeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, ndjekja e dhe vlerësimi i praktikës mësimore. GVJ konstatoi se AU ka zbatuar procedura formale për mbikqyrjen periodike të programit të studimit në nivel njësie bazë mbi baza vjetore dhe semestrale si: - Përditësimi dhe miratimi i syllabusve në fillim të vitit akademik; - Zhvillimi i pyetësorve periodik të studentëve në fund të semestrit; - Dosja e vetvlerësimit bazuar në kërkimin shkencor dhe angazhimet akademike; <i>Evidenca 2.19 Raport semestral i pedagogut</i>



arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.				
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Nga evidencat e paraqitura GVJ konstatoi se AU përdor gjithashtu dhe instrumenta të tërthorta për vlerësimin e cilësisë si: Pyetësorë të studentëve mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj, raportet e vlerësimit të pedagogëve, raportet e vetvlerësimit (2 herë në vit). Pasi përpunohen dhe analizohen të dhënat e mësipërme kthehen në formën e raporteve të cilat u vihen në dispozicion strukturave drejtuese dhe personelit akademik. <i>Evidenca. 1.33.3 Pyetjet për fokus grupe</i> <i>Evidenca 1.33.4 Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimin online V/A 2020-2021</i> <i>Evidenca 2.19 Raport semestral i pedagogut</i> <i>Evidenca 1.20 Praktikë/aktivitet me student Alumni</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se AU harton raporte me vlerësime periodike mbi vlerësimin e programit në të cilat kontatohet përputhshmëria e programit me kërkesat normative. Në këtë proces merret në konsideratë dhe opinion i studentëve.</i> <i>Në nivel Departamenti bëhen analiza vjetore të punës mësimore dhe kërkimore bazuar në përpunimin e pyetësorëve, formularëve të vetvlerësimit duke evidentuar arritjet dhe rekomandimet për të ardhmen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se peshën kryesore në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit e kanë aktorët të brendshëm si njësitë, zyrat dhe personat përgjegjës për garantimin e cilësisë së procesit mësimdhënës në institucion. Megjithatë institucioni garanton dhe përfshirjen e aktorëve të jashtëm në këtë proces si përfaqësues të bizneseve të interesuara për garantimin e cilësisë së studentëve dhe të programit të studimit. <i>Evidenca 2.52 Marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit/ nënshkruar vitet e fundit.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në aktet nënligjore të brendshme të institucionit si psh në Rregulloren e Përgjithshme dhe Rregulloren e NJSBC janë të parashikuara në mënyrë të qartë detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në procesin e sigurimit të cilësisë përfshirë strukturat drejtuese, njësitë akademike, stafin akademik dhe përfaqësuesit e studentëve. Aktet përcaktojnë rolin dhe përgjegjësitë e secilës palë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e standardeve të cilësisë duke garantuar ushtrimin me përgjegjësi dhe transparencë të detyrave përkatëse në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit. <i>Evidenca nr. 1.02 Rregullore e Përgjithshme AU</i> <i>Evidenca 1.07 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të	Në aktet e brendshme nënligjore të institucionit parashikohen të drejtat dhe detyrimet e njësive bazë, personelit akademik dhe ndihmës akademik, zyrave dhe njësive të tjera të institucionit në funksion të garantimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. AU ka ngritur NJSBC e cila ka për detyrë monitorimin në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerësimin periodic të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore. Në

personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e personelit akademik të njësisë bazë përgjegjes për programin e studimit, stafit ndihmës akademik dhe administrative.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se institucioni ka parashikuar norma përkatëse për besueshmërinë e procesit të vlerësimit duke përjashtuar çfarëdo trajtimi jo të barabartë të personelit akademik. Përfshirja e të gjithë aktorëve të brendshëm në vlerësimin e cilësisë bëhet në përputhje me parimet e integritetit akademik, barazisë dhe ndalimit të diskriminimit. Aktet rregullatore të brendshme përcaktojnë procedura që garantojnë respektimin e këtyre parimeve duke përfshirë stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrative dhe duke shmangur çdo formë pabarazie. <i>Evidenca 1.02 Rregullore e Përgjithshme AU</i> <i>Evidenca 1.15 Kodi i Etikes</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Rezulton se institucioni angazhon dhe aktorë të tjerë të jashtëm në procesin e vlerësimit të brendshëm. Proceset e vlerësimit të programit të studimit përfshijnë në diskutime edhe bashkëpunëtorët e Departamentit të angazhuar si staf akademik me kontratë apo atyre që monitorojnë praktikën e studentëve në pozicionin e përfaqësuesve të institucioneve partnere. Ky bashkëpunim sëbashku me angazhimin e stafit akademik efektiv dhe studentëve në procesin e vetvlerësimit garanton funksionimin efektiv të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. <i>Evidenca 1.01 Statuti AU</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka marrë masa në përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në proceset e sigurimit të cilësisë së programit të studimit.</i> <i>Në aktet e brendshme nënligjore përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë konkrete për secalin aktorë të përfshirë. Përfshirja realizohet në përputhje me parimet e integritetit akademik, barazisë dhe ndalimit të diskriminimit.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se politikat dhe strategjitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë publike dhe të aksesueshme për studentët dhe palët e interesuara përmes platformave online dhe dokumenteve zyrtare. Të gjitha proceset dhe aktivitetet e cilësisë zhvillohen në mënyrë transparente dhe janë publike për të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të institucionit si dhe në rrjetet e tjera komunikimit zyrtar. <i>Evidenca 1.04 Raporti Vjetor Institucional i Albania University VA 2023-2024</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga anazila e evidencave GVJ konstaton se raportet e vlerësimit publikohen, kurse raportet e veçanta iu komunikohen vecanërisht personelit akademik. GVJ konstatoi se AU aplikon praktika etike në publikimin e rezultateve të vlerësimeve duke respektuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas Statutit, Rregullores së Përgjithshme të AU dhe akteve ligjore në fuqi për arsimin e lartë në RSH. Rezultatet janë publike dhe të aksesueshme për të gjithë duke ruajtur lirinë akademike dhe standardet ligjore. <i>Evidenca 1.02 Rregullore e Përgjithshme AU</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e	GVJ konstaton se raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të institucionit përfshin edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi i vitit paraardhës. Plani i masave synon të adresojë në mënyrë të drejtpërdrejtë mangësitë dhe dobësitë e evidentuara gjatë procesit të vlerësimit duke përfshirë

mangësive e dobësive të evidentuara.	afate, personat përgjegjës dhe indikatorë për ndjekjen dhe zbatimin e tyre. <i>Evidenca 1.04 Raporti Vjetor Institucional AU</i> <i>Evidenca 2.10 Raporti Vjetor i FSHSH</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Konstatimet e rezultateve dhe të dhënave të publikuara përdoren për përditësimin e punës akademike, adresimin e gjetjeve dhe përmirësimin e situatës akademike në përgjithësi. DSHJPA zbaton një process të rregullt monitorimi dhe vlerësimi për të siguruar efektivitetin dhe ndikimin pozitiv të aktiviteteve në cilësinë e programit të studimit në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	AU zhvillon trajnime dhe takime për të informuar dhe ndërgjegjësuat stafin akademik dhe studentet mbi rëndësinë e sigurimit të cilësisë duke ndihmuar në krijimin e një culture të qëndrueshme për përmirësimin afatgjatë të cilësisë. <i>Evidenca 1.31 Trajnime stafi për përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se raportet lidhur me veprimtarinë vlerësuese janë periodike dhe të vazhdueshme. Ato shërbejnë për të konstatuar pikët e forta dhe pikat e dobëta të performancës së stafit akademik dhe cilësisë së procesit mësimdhënës në institucion.</i> <i>Në aktet rregullatore të brendshme të institucionit parashikohen mënyra, koha dhe vendi i publikimit të të gjithë veprimtarive në kuadër të procesit të vlerësimit të cilësisë në nivel institucioni duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Drejtësi”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi është në përputhje të plotë me misionin institucional, duke siguruar një strukturë akademike të standardizuar dhe të dokumentuar në funksion të programit të studimit;
2. Programi siguron një ekuilibër të qëndrueshëm midis teorisë, praktikës ligjore dhe punës kërkimore. Praktika profesionale (12 ECTS) dhe detyrimi përmbyllës (13 ECTS) janë të harmonizuara me legjislacionin në fuqi, duke mundësuar përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale;
3. Staf i akademik është i kualifikuar, shumica me tituj dhe grada shkencore si dhe përvojë të konsiderueshme në mësimdhënie dhe kërkim shkencor;
4. Trajnimet e vazhdueshme mbi metodat inovative dhe përdorimin e mjeteve digjitale kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ndërveprimit me studentët;
5. Metodatat interaktive dhe aktivitetet praktike rrisin nivelin e angazhimit të studentëve, ndërsa ekzistojnë struktura mbështetëse për tutorim, orientim profesional dhe ndjekjen e progresit akademik të studentëve;
6. Politikatat dhe procedurat akademike janë të dokumentuara dhe të aksesueshme, duke mundësuar monitorim të vazhdueshëm të performancës akademike të studentëve përfshirë pjesëmarrjen e studentëve dhe angazhimin e aktorëve të jashtëm;
7. Infrastruktura e programit është funksionale dhe e pajisur sipas kushteve bashkëkohore, duke përfshirë salla leksioni, biblioteka fizike dhe online, pajisje teknologjike dhe akses në internet;
8. Në funksion të programit të studimit ka bashkëpunime me institucione për zhvillimin e praktikës profesionale të studentëve si dhe projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, duke nxitur mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve për zhvillimin profesional dhe kërkimor;
9. AU ofron mbështetje ekonomike për studentët që kanë arritur rezultate të shkëlqyera si dhe studentët me status “në nevojë”;

b. Pika të dobta:

1. Ngarkesa mësimore e lartë (290 – 440 orë/vit) ndikon negativisht në cilësinë e mësimdhënies dhe angazhimin e stafit në aktivitete kërkimore, projekte dhe punë administrative; (*Standardi IV.1, Kriteri 2*)
2. Disa anëtarë të personelit akademik nuk kanë kualifikimin për këtë cikël studimi dhe nuk janë plotësisht të profilizuar sipas këtij kualifikimi për lëndët që mbulojnë; (*Standardi IV.1, Kriteri 1*)
3. Literatura e detyrueshme e syllabusve në disa raste rezulton e mbingarkuar dhe shpesh përfshin akte ligjore si dhe praktika gjyqësore; (*Standardi IV.3, Kriteri 1*)

4. Lënda “E Drejtë Penale” ka një ngarkesë të lartë mësimore në këtë program studimi me 16 ECTS; *(Standardi II.1, Kriteri 1)*

Rekomandime

1. Institucioni të marr masa për uljen e ngarkesës mësimore të PAE duke qënë se një ngarkesë kaq e lartë (290-440) ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies si dhe në angazhimin e personelit akademik në punë kërkimore dhe angazhim institucional;
2. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimit të marr masa për plotësimin sa më parë të kualifikimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;
3. Lënda “E drejta Penale” ka një ngarkesë të lartë mësimore në një vit akademik (16 ECTS) prandaj rekomandojmë të ndahet në dy vite akademike përkatësisht në modulet “E Drejtë Penale e Përgjithshme” dhe “E Drejtë Penale e Posacme” për shkak të ngarkesës dhe rëndësisë që ka kjo lëndë në formimin profesional të studentëve të këtij programi studimi;
4. Të rishikohen një pjesë e konsiderueshme e syllabuseve përsa i përket literaturës së detyrueshme e cila rezulton e mbingarkuar për studentët me 8-15 tituj;
5. Numri i studentëve të regjistruar (8–10 studentë/vit) është relativisht i ulët. Rekomandohet intensifikimi i promovimit të programit, përmirësimi i strategjive të rekrutimit dhe ndjekja aktive e alumni-t për të rritur regjistrimet dhe përfshirjen e studentëve;

Evaluation’s conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in “Law”

a. Strengths and affirmations:

1. The program is fully consistent with the institutional mission, providing a standardized and documented academic structure in function of the study program;
2. The program ensures a sustainable balance between theory, legal practice and research. The professional internship (12 ECTS) and the final obligation (13 ECTS) are harmonized with the legislation in force, enabling the preparation of students for professional challenges;
3. The academic staff is qualified, most with scientific titles and degrees as well as considerable experience in teaching and scientific research;
4. Continuous training on innovative methods and the use of digital tools contributes to improving the quality of teaching and interaction with students;

5. Interactive methods and practical activities increase the level of student engagement, while support structures exist for tutoring, professional orientation, and tracking of students' academic progress;
6. Academic policies and procedures are documented and accessible, enabling continuous monitoring of student academic performance including student participation and engagement of external stakeholders;
7. The program's infrastructure is functional and equipped according to contemporary conditions, including lecture halls, physical and online libraries, technological equipment, and internet access;
8. In function of the study program, there are collaborations with institutions for the development of students' professional practice as well as joint national and international projects, promoting the mobility of academic staff and students for professional and research development;
9. AU offers financial support to students who have achieved excellent results as well as students with "need" status;

b. Weaknesses:

1. The high teaching workload (290–440 hours per year) negatively affects the quality of teaching and the engagement of the academic staff in research activities, projects, and administrative duties; (*Standard IV.1, Criterion 2*)
2. Some members of the academic staff do not possess the required qualification level for this study cycle and are not fully specialized according to the profile of the subjects they teach; (*Standard IV.1, Criterion 1*)
3. The mandatory literature listed in some syllabi is overloaded and often includes legal acts as well as judicial practice, making it difficult for students to focus on the essential academic materials; (*Standard IV.3, Criterion 1*)
4. The course Criminal Law has a high teaching load within this study program, carrying 16 ECTS credits; (*Standard II.1, Criterion 1*)

Recommendations

1. The institution should take measures to reduce the teaching workload of the academic staff, as an excessive load (290–440 hours per year) directly affects the quality of teaching, as well as the staff's engagement in research activities and institutional involvement;
2. The base unit responsible for this study program should take immediate action to ensure that the academic staff involved in the program meet the required qualification standards;
3. The course Criminal Law carries a high teaching load within one academic year (16 ECTS); therefore, it is recommended to divide it into two academic years, respectively into the modules General Criminal Law and Special Criminal Law, due to its volume and significance in the professional formation of the students;

4. A considerable number of course syllabi should be reviewed, as the mandatory literature is currently overloaded, including between 8–15 titles per subject, which may be excessive for students;
5. The number of enrolled students (8–10 per year) is relatively low. It is recommended to intensify the promotion of the program, improve recruitment strategies, and strengthen alumni follow-up to increase enrollment and student engagement;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

